



TAKIM PERIODIK ME MEDIA

Më datë **25.11.2024** në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan u zhvillua seminari me përfaqësues të medias.

Prologu i takimit nisi me fjalën përshëndetëse të Zv/ Kryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan z. Artur Prenga, i cili vlerësoi impenjimin aktiv të përfaqësuesve të medias, si edhe rëndësinë e referimit dhe diskutimin e çdo problematike nga media për rritjen e transparencës publike të Gjykatës.

Takimi vijoi me referimin e Gjyqtarit të Medias z. Ardit Kuka.

Në pjesën e parë të takimit, përfaqësuesit e medias referuan mbi vështirësitë e hasura gjatë punës në lidhje me raportimet e tyre mbi gjyqësorin, si edhe interesin e tyre në lidhje me trajtimin e tematikave dhe çështjeve për gjykim me interes të lartë publik, veçanërisht për çështjet me të miturit në konflikt me ligjin.

Gjyqtari i Medias z. Ardit Kuka referoi në këtë takim për:

- Solemnitetin e gjykimit, referuar Vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë Nr.238/1/B, Datë 24.12.2008.
- Rregullat e askesit në seancë gjyqësore nga përfaqësuesit e medias.



- Prezantimi lakonik dhe në gjuhë të thjeshtë i pikave kryesore të Udhëzuesit Standard të Marrëdhënieve të Gjykatave me Publikun dhe Median të miratuar me Vendim Nr. 716, Datë 06.12.2023 nga Këshilli Lartë Gjyqësor, me përparësi u vendos theksi në Nenet Nr.:8, 9, 10, 12 dhe 14 të këtij udhëzuesi.
- Prezantimi i Formularit të Kërkesës për Regjistrim të Seancave Gjyqësore, si edhe mënyra e plotësimit të tij.
- Mbledhja e të dhënave për pajisjen me karta të përfaqësuesëve të medias.

Në fund të takimit Gjyqtari i Medias z. Ardit Kuka, propozoi organizimin e takimeve periodike me mediat. Takime të cilat do të organizohen në formën e seminareve me karkater informues juridik, përpos diskutimit të problematikave të hasura dhe tematikave të propozuara nga vetë media në vijim.

Falenderojmë të gjithë përfaqësuesit e medias që mundën të marrin pjesë në këtë takim.

Organizimi i takimeve të tilla na ndihmon të evidentojmë problematikën, si edhe të përmirësojmë punën tonë për një Gjykatë që synon transparencë publike, të pavarur, etike dhe efikase.



DEGA TERRITORIALE E SHËRBIMIT TË PROVËS ELBASAN

Më datë **02.12.2024**, Zv/Kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan **z. Artur Prenga**, mirëpriti në një tryezë takimi Drejtorin e Degës Territoriale të Shërbimit të Provës Elbasan **z. Gentjan Gazidedja**, Specialistët: **znj. Irena Gorrica** dhe **z. Shukri Marku**.

Takimi u realizua me synim rritjen e ndërveprimit institucional në funksion të mbarëvajtjes së proceseve gjyqësore dhe standardizmin e praktikave të njësura, inkurajimi për zbatimin e dënimeve alternative, vijimin e një bashkëpunimi eficient ndërmjet institucioneve për paraqitjen e raporteve para gjykatës, për garantimin e të drejtave dhe lirive themelore në zbatim të konfidencialitetit, besueshmërisë dhe integritetit.





03 DHJETOR DITA NDËRKOMBËTARE E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR

Më datë **03 Dhjetor 2024**, në kujtesë të Ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuar, **Zv/Kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan z. Artur Prenga**, Gjyqtari i Medias z. **Ardit Kuka** dhe Gjyqtarja **znj. Suela Lika**, mirëpritën drejtues, mësues dhe nxënës të shkollave të mesme: **Dhaskal Todri**, **Medrese Liria**, **Ahmet Dakli** të qytetit të Elbasanit, në një takim i cili u realizua në vazhden e aktiviteteve me nxënës të shkollave të mesme, të cilët u angazhuan në asistimin e nxënësve për krijimin e eseve me tematikë “Inkluzioni dhe të Drejtat e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar”, të krijuara nga nxënësit në kuadër të Javës së Drejtësisë, për të cilin vlerësojmë kontributin dhe angazhimin e të gjithë nxënësve, si edhe të mësueses **znj. Ersida Buzo** të Shkollës së Mesme **Dhaskal Todri**, mësueses **znj. Tire Kamberi** të Shkollës së Mesme Jopublike **Medrese Liria**, të drejtueses **znj. Mimoza Belshi** të Shkollës së Mesme **Ahmet Dakli**.

Më datë **03 Dhjetor 2024**, finalizuam certifikimin e pjesëmarrjes së tyre në krijimin e eseve, me synimin e përhapjes dhe zhvillimit aktiv të njohurive të kuadrit ligjor tek fëmijët, aftësimin dhe njohjen e fëmijëve me të drejtat e tyre, si edhe të drejtat e fëmijëve me Aftësi të Kufizuar, për të mundësuar sensibilizimin e këtij target grupi mbi të drejtat e bashkëmoshatarëve të tyre të ndodhur në kushte të Aftësisë së Kufizuar.




Në fjalën e tij **Zv/Kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan z. Artur Prenga** referoi se, gjeneza e Ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuar 3 Dhjetor, u vendos me Rezolutën 47/3 në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, duke theksuar se qëllimi i kësaj dite është promovimi i të drejtave të personave me Aftësi të Kufizuar ku janë pjesë edhe fëmijët. Edukimi gjithëpërfshirës (Inkluziv) duhet të synojë për një edukim të fëmijëve në përshtatje me nevojat e tyre të veçanta. Secili prej nesh mund të ketë formuar një perceptim ndaj këtij procesi, por zgjerimi i informacionit përmes leximit, apo marrjes pjesë në mënyrë direkte dhe dinamike në këtë proces, do të na ndihmojë të kuptojmë se, gjithëpërfshirja është një proces që duhet të sigurojnë institucionet arsimore dhe shtetërore, për përfshirjen e nxënësve në veprimtarinë edukative, mësimore dhe jetike për këtë kategori në nevojë. Vëmendja, jo vetëm e shoqërisë por edhe e legjislativit është e posaçme ndaj kategorisë së personave me Aftësi të Kufizuar, veçanërisht e të miturve me Aftësi të Kufizuar.

Gjyqtarja znj. Suela Lika, referoi në lidhje me kujdesin e treguar të ligjvënësit për këtë kategori të caktuar, pa dashur të përcaktohet dhe targetohet si e tillë, por për shkak të specifikave dhe nevojave që personat me Aftësi të Kufizuar, veçanërisht të miturit, kanë. Gjyqtarja theksoi se duhet që të rinjtë të informohen në mënyrë progresive në lidhje me të drejtat e tyre dhe të personave me Aftësi të Kufizuar. Të rinjtë, por edhe e gjithë shoqëria duhet të dijnë se, parashikimet e Kodit Penal për veprat penale të kryera ndaj personave me Aftësi të Kufizuar të rritur apo të mitur, parashikon ashpërsim të masave të dënimit për këtë kategori veprash, në të cilat viktimë janë personat me Aftësi të Kufizuar.



Gjyqtari i Medias z. Ardit Kuka, referoi mbi Kuadrin Ligjor Ndërkombëtar për mbrojtjen e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar, duke veçuar Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara KPAK, e OKB-së viti 2006, e cila ka si qëllimi të nxisë, mbrojtje dhe të sigurojë që të gjithë personat me Aftësi të Kufizuar të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të nxisë respektin për dinjitetin e tyre. Konventa është impelmentuar dhe përmirësuar në Kuadrin Ligjor Kombëtar, i cili thekson nevojën për përmirësimin e statusit për punësimin që sipas Ligji nr.7995, dt.20.09.1995 "Për nxitjen e punësimit", siguron dhe mbështet punësimin, këshillimin dhe kualifikimin profesional për personat me Aftësi të Kufizuara. Neni 15 parashikon që subjektet që kanë të punësuar 25 punonjës, një prej tyre duhet të jetë me Aftësi të Kufizuar në gjendje të punojë.

Në takim kishim të ftuar nëpunësin e Ndihmës Juridike të Garantuar nga Shteti dega Elbasan z. **Arian Bala**, në kuadër të bashkëpunimit të vazhdueshëm me institucionet për administrimin dhe funksionimin e sistemit të Ndihmës Juridike dhe rritjes së ndërgjegjësimit tek qytetarët në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e të gjithë aktorëve të përfshirë. Z. Arian Bala, referoi për të pranishmit mbi konceptin e Ndihmës Juridike të Garantuar nga Shteti, shërbim i cili jepet në formën e ndihmës juridike parësore dhe dytësore, që mundëson përjashtimin nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore, si edhe përjashtimin nga detyrimi për të parapaguar tarifën e vënies në ekzekutim të urdhrat të ekzekutimit për shtresat në nevojë. Ndihma Juridike e Garantuar nga Shteti sanksionohet me Ligj Nr. 111/2017 "Për Ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti."



Në **përfundim** në këtë takimi, rekomandua për nxënësit leximin e librit jashtëshkollor me autor profesorin, përkthyesin, publicistin dhe shkrimtarin shqiptar z. **Edmond Tupe** me titull **"Kur dhimbja premtori dashuri"**, një libër i cili përshkruan jo vetëm një histori njerëzore të jetuar, po një udhëzim, një leksion të vyer për të gjithë ata prindër që kanë fëmijën e tyre me Aftësi Ndryshe dhe jo vetëm. Një libër që shtron emocione mëndafshi që nisin, si edhe shprehet autori **"me ëndërrat e thurura me zë të lartë për të ardhmen e fëmijës së tyre pafundësisht të brishtë, të pambrojtur, aq të dhunshëm kur vuan por dhe aq i mrekullueshëm kur shpreh dashurinë, mirënjohjen apo pendesën e tyre, frymëmarrja e vetme që i jep kuptim jetës së tyre të përditshme, që ua kthen errësirën në dritë dhe dëshpërimin në forcë."** dhe mbyllet me lutjen e dëshpëruar të një prindi të sflitur nga dhimbja drejtuar **"Rastësisë, Natyrës apo Zotit, pak rëndësi ka për të bërë atë fëmijë thjesht N-O-R-M-A-L, si shumica e fëmijëve të kësaj bote, të kësaj jete!"**, duke përcjellë kështu një mesazh të fortë nëpërmjet përvojës jetësore të një familje me fëmijë me Aftësi Ndryshe, që reflekton një motiv të madh për të jetuar.

E referua këtë libër me shpresën dhe dëshirën e mirë për të sensibilizuar të rinjtë në kultivimin e njohurive jo vetëm ligjore, por edhe ndjesive humane në mbështetje të këtij target grupi në nevojë, por edhe të familjarëve të tyre, të cilët jetojnë me brengën e madhe për vështirësitë dhe fatin e të vegjëlve të tyre, duke shpresuar në përhapjen e dritës së mirë tek të rinjtë, me shpresën, si edhe shprehet psikoanalisti i mirënjohur Carl Gustav Jung në librin e tij, Liber Primus **"Fuqia e dritës së mirë është aq e madhe sa edhe errësira që i kundërvihet qartësohet. Asgjë nuk është perfekte, dhe shumëçka është në kundërvënie. Rruga e jetës është transformim, jo përjashtim. E mira, është një gjykatës më i mirë se ligji."**

Në këtë aktivitet, është mbajtur në konsideratë e drejta e lejimit të publikimit të fotove dhe videove të pjesëmarrjes së fëmijëve në aktivitet, me miratim e Lejes së Prindërve të kërkesës së paraqitur nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan tek Institucionet Arsimore.





KËSHILLI RINOR I BASHKISË ELBASAN

Më datë **10.12.2024** Zv/ Kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan **z. Artur Prenga**, mirëpriti Këshillin Rinor të Bashkisë Elbasan, në një takim në kuadër të afrimit të komunitetit me gjykatat, përmes organizimit të aktiviteteve publike në zbatim të Planit Strategjik të Komunikimit të miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për ti dhënë mundësi anëtarëve të Këshillit Rinor të Bashkisë Elbasan të njihen me veprimtarinë, ambientet dhe funksionet e gjykatës. Zv/ Kryetari **z. Artur Prenga** mbajti një diskutim të lirë me pjesëmarrësit duke i shpjeguar me një gjuhë të thjeshtë dhe të përshtatshme për moshën e tyre misionin e gjykatës, funksionin dhe rëndësinë e gjyqësorit në sistemin e drejtësisë, kompetencën tokësore në të cilën ushtron funksionin e saj Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Pjesëmarrësit shfaqën interesin e tyre gjatë bisedës për funksionin dhe detyrat që ushtron Zv/ Kryetari i Gjykatës, si edhe objektivat dhe prioritetet që gjykata ka vendosur për realizim në vitin 2025.

Në këtë aktivitet të rinjëve të Këshillit Rinor të Bashkisë Elbasan iu krijua mundësia e njohjes me strukturën e institucionit duke nisur nga sallat e zhvillimit të seancave gjyqësore, zyrat e shërbimit të administratës, ambientet e arkivave, duke iu shpjeguar ndërkohë gjatë vizitës veprimtaritë dhe funksionet e zyrave të shërbimit si edhe funksionimit të gjyqësorit në tërësi.

Falenderojmë z. Sokrat Ndria, Përgjegjës Sektori i Rinisë në Bashkinë Elbasan dhe Specialistët: z. Alban Shingjergji dhe Durim Çopja, për angazhimin dhe organizimin e të rinjëve në funksion të njohjes së të rinjëve me institucionet si pjesë e kurrikulave të këshillimit të karrierës.



Në këtë aktivitet, është mbajtur në konsideratë e drejta e lejimit të publikimit të fotove dhe videove të pjesëmarrjes së fëmijëve në aktivitet, me miratimn e drejtuesve të Këshillit Rinor të Bashkisë Elbasan e cila organizon aktivitetet të vazhdueshme edukative për pjesëmarrësit e Këshillit Rinor.





TAKIM NDËRINSTITUCIONAL ME STUDENTË TË FAKULTETIT TË BIZNESIT DHE DREJTËSISË TË UNIVERSITETIT “ALEKSANDËR XHUVANI” DHE SHKOLLËS 9- VJEÇARE “NAIM FRASHËRI”

Më datë **11.12.2024**, me studentë të Fakultetit të Biznesit dhe Drejtësisë të Universitetit “Aleksandër Xhuvani” vizituam klasat e 9-ta të shkollës “Naim Frashëri” Elbasan.

Projekti lindi si ide nga frekuentimi i “Orëve të Hapura në Gjykatë”, ku studentë të Fakultetit të Biznesit dhe Drejtësisë të Universitetit “Aleksandër Xhuvani” Elbasan, të cilët ndjekin vazhdimisht seanca me dyer të hapura të seksionit penal dhe civil, pranuan ftesën për angazhim në projekte të tjera të Gjykatës në lidhje me promovimin e të drejtave për të miturit dhe informimin e kuadrit ligjor për të mitur. Falenderojmë Zv/ Kryetarin e Gjykatës z. Artur Prenga dhe Trupën Gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, të cilët pavarësisht ngarkesës së lartë të çështjeve për gjykim, mirëpresin studentët në ndjekjen e seancave gjyqësore.

Projekt- ideja për zhvillimin e një sërë aktiviteteve me objekt “Këshillim karriere, sensibilizim dhe njohje e të miturve me kuadrin ligjor të drejtësisë për të mitur” u mbështet dhe u formalizua me asistimin dhe qëllimin për të patur një shtrirje më të gjërë në disa institucione edhe jashtë Gjykatës nga Zv/ Kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan z. Artur Prenga dhe Gjyqtari i Medias z. Ardit Kuka të cilët udhëzojnë dhe mbështesin formalizimin e projekteve nga ana profesionale dhe ligjore, projekte të cilat Zv/ Kryetari i Gjykatës z. Artur Prenga, synon të rriten në nivele profesionale bashkëpunimi me finalizimin e lidhjes së Marrëveshjeve me Institucionet Arsimore përkatëse.





Ky projekt nisi me shkollën 9-vjeçare “Naim Frashëri” Elbasan me bashkëpunimin proaktiv të Koordinatorës së Orientimit në Karrierë znj. Fatbardha Nergjoni dhe Drejtueses së shkollës “Naim Frashëri” të cilat mundësuan akesin dhe pritjen në shkollën 9-vjeçare “Naim Frashëri” Elbasan.

Vlerësojmë shumë impenjimin dinjitoz të grupit të studentëve; **Aleks Kola, Ira Sinani, Sara Sollaku, Sindi Xhyra, Andi Paja**, të cilët tejkaluan pritshmëritë tona në realizimin e detyrave të caktuara për përpunimet e materialeve që referuan për nxënësit, duke u bazuar në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur, rastet praktike të shfaqura me një gjuhë të thjeshtë dhe të përshtatshme për ndërgjegjësimin e të miturve, për mënyrat se si duhet të sillen në raste konfliktuale, ku duhet ta adresojnë shqetësimin e tyre për zgjidhje, rëndësisë që duhet t'i japin veprimeve dhe mosveprimeve të tyre në ambientet e shkollës dhe jashtë saj, për të mos u bërë subjekte të kryerjes së veprave penale apo viktimë e veprave penale, për të njohur vlerën e asaj që është më e shtrenjtë për individin në çdo shoqëri: jetesën në një shoqëri tolerante, të drejtë dhe të jetuarit të lirë. Në një bashkëbisedim sa të ngrohtë, por edhe profesional studentët referuan dhe këshilluan nxënësit për zgjedhjen e studimeve në fushën e të drejtës, e cila orientohet dhe finalizohet në arritje profesionale që finalizohen me profesione të nderuara si: juristë, avokatë dhe magjistratë, duke shpjeguar hapat dhe rrugën që ndiqet për të mundësuar këto arritje profesionale. Duke shpresuar që në vijim me impenjim dhe dëshirë të mirë të kristalizojmë dhe materializojmë Projekte dhe Plane Komunikimi efçente dhe efektive ndërinstitucionale jo vetëm me të mitur, por dhe me aktorë të tjerë në nevojë të shoqërisë, për njohjen praktike të drejtave dhe detyrimeve ligjore.

Në finalizim të këtij projekti **studentët janë certifikuar më datë 29.05.2025** për kontributin e tyre në këtë projekt informues dhe këshillues të kuadrit ligjor për të miturit.





DHOMA VENDORE E AVOKATISË ELBASAN

Më datë **12.12.2024**, Zv/ Kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan **z. Artur Prenga**, mirëpriti avokatët e Dhomës Avokatisë Elbasan, për të dëgjuar shqetësimet e tyre në raport me Gjykatën, nëpërmjet adresimit dhe referimin të saktë të problematikave të hasura, në kuadër të forcimit të komunikimit dhe bashkëpunimit ndërmjet Gjykatës dhe grupeve të interesit.

Ndër të tjera, gjatë diskutimit Zv/ Kryetari i Gjykatës **z. Artur Prenga** siguroi pjesëmarrësit se:

- Çdo shqetësim i tyre do të vlerësohet me objektivitetin e duhur për të siguruar zgjidhje efëiente.
- Gjykata ka ndërmarrë masa të bazuara në “Strategjinë Kombëtare të Uljes së Numrit të Çështjeve të Prapambetura në Gjykata (2024-2027)” dhe ka njoftuar paraprakisht me njoftim publik palët në procese gjyqësore, avokatët dhe publikun se tashmë janë ngritur grupet e punës për evidentimin, kategorizimin dhe inventarizimin e grupçështjeve që do të vendosen në lëvizje me procedurë të përshpejtuar.
- Aplikimi i masave të ndërmarra do të njoftohet vazhdimisht nëpërmjet njoftimeve publike në faqen zyrtare të Gjykatës dhe rrjetet sociale, si edhe në ambientet e dedikuara në Gjykatë për vendosjen e njoftimeve, në mënyrë që informimi të ketë shtrirje të plotë.
- Zv/ Kryetari i Gjykatës **z. Artur Prenga** kërkoi nga pjesëmarrësit që të respektohet solemniteti i gjykimit, të kryhet rifreskimi i listës së avokatëve të caktuar kryesisht, depozitimi i kërkesave apo ankesave të kryhet i plotë me bashkëlidhje të provave.

Në përfundim, Zv/ Kryetari i Gjykatës **z. Artur Prenga** falenderoi avokatët për pjesëmarrjen e tyre, pasi që referimi, diskutimi dhe trajtimi i duhur i problematikave do të sigurojë mbarëvajtjen e punës me proceset gjyqësore, zyrat e shërbimit, transparencën publike dhe vendimmarrje të drejta.





BASHKITË E QARKUT ELBASAN


Më datë **16.12.2024**, me ftesë të Zv/ Kryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan **z. Artur Prenga**, u zhvillua takimi me Kryetarët e Bashkive të Qarkut të Elbasanit.

Në takim ishin të ftuar:

- Kryetari i Bashkisë Elbasan **z. Gledian Llatja**;
- Kryetari i Bashkisë Cërrik **z. Andis Salla**;
- Kryetari i Bashkisë Librazhd **z. Mariglen Disha**;
- Nënkryetari i Bashkisë Elbasan **z. Asim Sula**;
- Përgjegjëse e Sektorit të Informimit në Bashkinë Elbasan **znj. Leda Sejдини**.

Takimit u zhvillua në kuadër të rritjes së Ndërveprimit Institucional ndërmjet Bashkive të Qarkut të Elbasanit dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, mbi standardizimin e procedurave dhe krijimin e pikave të kontaktit për ndërveprimet procedurale mes Gjykatës dhe Zyrave të Shërbimeve Sociale në Bashkitë e Qarkut, kryesisht me Sektorin e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Barazisë Gjinore, pjesë e strukturave të Organikave të Bashkive.

Zv/ Kryetari **z. Artur Prenga** në fjalën e tij ndër të tjera theksoi se, vlerëson angazhimin dhe pjesëmarrjen e Kryetarëve të Bashkive në këtë takim i cili do të shërbejë në ndërtimin e një bashkëpunimi të vlefshëm ndërinstitucional ndërmjet Gjykatës me strukturat e pushtetit lokal, i cili ka rëndësi thelbësore në plotësimin e kuadrit institucional për zbatimin në praktikë të Legjislacionit për Drejtësinë për të Miturit në Konflikt me Ligjin dhe Barazinë Gjinore.





Është e rëndësishme të kemi një ndërveprim eficient ndërmjet Zyrave të Shërbimit Social, kryesisht Sektorit të Mbrojtjes së Fëmijëve në Konflikt me Ligjin, për mbarëvajtjen e proceseve gjyqësore, duke mbajtur në konsideratë detyrimin, respektimin dhe garantimit e të drejtave të parashikuara nga Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, me qëllim garantimin e procesit të rregullt ligjor për të miturit e përfshirë në procese gjyqësore. Theksoj se, për garantimin e gjykimit brenda një kohe të arsyeshme është e rëndësishme mbështetja e të miturit në çdo proces nga profesionistë të cilët janë të trajnuar dhe specializuar për çështjet e drejtësisë për të miturit, ndaj është e rëndësishme të shihet me prioritet ndërveprimi institucional për mbarëvajtje dhe sigurim të proceseve ligjore të rregullta për të Miturit në Konflikt me Ligjin.

Kryetari i Bashkisë Elbasan **z. Gledian Llatja** në fjalën e tij theksoi se, qendrat multidisiplinare pranë Bashkisë Elbasan janë aktualisht funksionale, si edhe Grupet Teknike Ndërsektoriale (GTN), ku marrin pjesë Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijëve (PMF), si psikologë, punonjës socialë dhe të tjerë profesionistë të fushave të cilët kryejnë vlerësimin e nevojave të të miturit, por ndihet nevoja për trajnim të posaçëm të administratës, kryesisht Sektorit të Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Barazisë Gjinore, në lidhje me asistimin profesional për garantimin e proceseve ligjore të rregullta.

Kryetari i Bashkisë Elbasan **z. Gledian Llatja** vlerësoi punën dhe mbështetjen që japin Organizatat Joqeveritare si Terre des hommes (Tdh për ndihmën ndaj fëmijëve, në partneritet me Tjeter Vizion me financim të Agjencisë Austriake për Zhvillim dhe ADC në Shqipëri etj., të cilat japin një kontribut të vlefshëm për të mbështetur fëmijët viktimë të abuzimit dhe dhunës në integrimin e politikave dhe strategjive të kuadrin ligjor ekzistues.





OJQ-të kanë mundësuar që fëmijët e prekur të kenë akses në shërbime psikosociale, këshillim dhe aktivitete rekreative të cilat mbështeten nga Bashkimi European, UNICEF, Austrian Development Agency etj. Kryetari i Bashkisë Elbasan z. Gledian Llatja në këtë takim, propozoi lidhjen e një marrevëshje mes Gjykatës dhe Bashkive të Qarkut në mënyrë që Gjyqtarët Magjistratë të Seksionit Penal për të Mitur që ushtrojnë funksionin e tyre në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit Elbasan, të kryejnë seminare trajnimi të nëpunësve të administratës së Bashkive të Qarkut Elbasan, për sektorin që mbulon Zyrat e Shërbimeve Sociale në Bashkitë e Qarkut Elbasan, kryesisht Zyrat e Shërbimit Social në Sektorin e Mbrojtës së Fëmijëve dhe Barazisë Gjinore.

Në vijim, në funksion të këtij takimi, do të ngihen strukturat e posaçme me grupet e punës mes Gjykatës dhe Bashkisë Elbasan, të cilët do të hartojnë procedurat konkrete për vendosjen në praktikë të këtij Projekti-Ndërinstitucional, për realizimin e trajnimeve të nëpunësve të administratës së Bashkive të Qarkut Elbasan, që do të specializohen për çështjet e drejtësisë për të miturit. Kryetari i Bashkisë Elbasan z. Gledian Llatja ofroi mbështetjen e tij për sigurimin e ambienteve dhe grupeve teknike të posaçme në mbështetje të zhvillimit të Seminarëve Trajnues të administratës së Bashkive të Qarkut në ambientet e Bashkisë Elbasan, ndërkohë që ky propozim gjeti mbështetje nga Zv/ Kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan z. Artur Prenga për sigurimin e kushteve optimale të zhvillimit të këtij projekti, si edhe Kryetarit të Bashkisë Librazhd z. Mariglen Disha dhe Kryetarit të Bashkisë Cërrik z. Andis Salla.



TAKIM NDËRINSTITUCIONAL ME PËRFAQËSUES TË UNIVERSITETIT “ALEKSANDËR XHUVANI”


Sot, më datë **06.02.2025** në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, u zhvillua takimi për nënshkrimin e **Marrëveshjes së Bashkëpunimit (Internship) “Për Zhvillimin e Praktikave Profesionale”** ndërmjet Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”.

Në takim ishin të ftuar:

-**Rektorja** e Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” **znj. Elvira Fetau**,
-**Dekani** i Fakultetit të Biznesit dhe Drejtësisë në Universitetin “Aleksandër Xhuvani” **z. Shpetim Çerri**.

Të ftuarit u mirëpritën nga **Zv/ Kryetari** i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan **z. Artur Prenga** dhe **Gjyqtari i Seksionit Penal** **z. Elis Dine**.

Nënshkrimi i kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi, u realizua në kuadër të rritjes së Ndërveprimit Institucional ndërmjet dy institucioneve, duke njohur rëndësinë e përgatitjes profesionale të studentëve dhe domosdoshmërinë e lidhjes midis arsimit teorik dhe praktikës profesionale. Kjo iniciativë, ka për qëllim nxitjen e punësimit me qëllim formimin profesional nëpërmjet punës.





Zv/ Kryetari i Gjykatës z. Artur Prenga në fjalën e tij theksoi se, *“Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi, e cila do të zhvillohet nëpërmjet një Programi Intershipi të detajuar dhe në përputhje me të drejtat dhe detyrimet ndërinstitucionale që rrjedhin prej saj, do t’u mundësojë studentëve të përfitojnë në termat e një programi “Puno dhe studio” eksperiencë pune në administratën gjyqësore. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan do të angazhohet maksimalisht që të sigurojë një ambient të sigurt dhe të përshtatshëm për zhvillimin e praktikës profesionale në ambientet e saj, si edhe do të përfshijë studentët në aktivitete edukative dhe praktike, të lidhura ngushtësisht me funksionimin e përditshëm të Gjykatës, duke ruajtur parimin e konfidencialitetit të çështjeve gjyqësore.”*

Gjyqtari z. Elis Dine, shprehu gadishmërinë dhe përkushtimin e të gjithë Trupës Gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan në mbështetje të këtij projekti. Angazhimin për krijimin e mundësive dhe lehtësimin e aksesit të studentëve në proceset gjyqësore, si dhe asistimin e mbështetjen profesionale për zhvillimin e aftësive praktike të studentëve.

Rektorja e Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” znj. Elvira Fetau në fjalën e saj theksoi se, Universiteti i Elbasanit *“Aleksandër Xhuvani” do të angazhohet maksimalisht në zhvillimin e këtij programi në përputhje me të drejtat dhe detyrimet ndërinstitucionale që lindin nga kjo Marrëveshje Bashkëpunimi, të cilën e cilësoi si një “motivim i madh” për studentët e Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” .*



Nëpërmjet këtij Programi Intershipi, studentët jo vetëm do të zhvillojnë aftësitë e tyre profesionale me angazhimin e tyre në praktikën për punët administrative gjyqësore në Gjykatë, por do të jenë një dritare e mirë e promovimit të punës, angazhimit, përkushtimit të Universitetit në zhvillimin profesional të studentëve, nismë e cila do të flasë për të brez pas brezi dhe do të lartësojë emrin dhe punën e Universitetit “Aleksandër Xhuvani” .

Dekani i Fakultetit të Biznesit dhe Drejtësisë në Universitetin “Aleksandër Xhuvani” **z. Shpetim Çerri** shprehu entuziazmin dhe mbështetjen e tij në këtë projekt për përzgjedhjen e studentëve në Fakultetin e Biznesit dh Drejtësisë në përputhje me strategjinë e zhvillimit të Universitetit të Elbasanit, si dhe monitorimin dhe vlerësimin e ecurisë së studentëve në përputhje me metodologjinë e përcaktuar duke synuar garantimin e standardeve të larta të cilësisë dhe performancës gjatë praktikës profesionale.

Në mbyllje të takimit, **Zv/ Kryetari i Gjykatës z. Artur Prenga** dhe **Rektorja e Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” znj. Elvira Fetau**, nënshkruan Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve (Intership) **“Për Zhvillimin e Praktikave Profesionale”**.

Në vijim, në funksion të kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi do të ngrihen strukturat e posaçme me grupet e punës dhe personat përgjegjës për mbarëvajtjen e zhvillimit dhe zbatimit të saj.





TAKIMI ME AMBASADOREN E REPUBLIKËS FEDERALE TË AUSTRISË NËSHQIPËRI ZNJ. MONIKA ZACH DHE PËRFAQËSUES TË PROJEKTIT “MBËSHTETJE PËR DREJTËSINË E AKSESUESHME PËR GRATË DHE BURRAT NË SHQIPËRI” UNDP (UNITED NATIONS DEVELOPMENT PROGRAMME) DHE ADC (AUSTIAN DEVELOPMENT COOPERATION).

Sot, më datë **12.02.2025** në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, u zhvillua takimi në kuadër të projektit “Mbështetje për Drejtësinë e Aksesueshme për Gratë dhe Burrat në Shqipëri” UNDP (United Nations Development Programme) dhe ADC (Austian Development Cooperation).

Në takim ishin të ftuar:

Pala Austriake

- Ambasadorja e Republikës Federale të Austrisë në Shqipëri znj. Monika Zach;
- Drejtori i Zyrës Rajonale të Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim (ADC) z. David Muckenhuber;
- Menaxherja e Programit znj. Elona Fana;

UNDP

- Shefja e Programit të Përfshirjes Sociale znj. Entela Lako;
- Shefja e Komunikimit dhe Partneriteteve znj. Nora Kushti;
- Menaxherja e Projektit të Aksesit në Drejtësi znj. Vilma Çobani;





Drejtoria e Përgjithshme e Ndihmës Juridike Falas

- Drejtori i Përgjithshëm z. Ergys Qirici;
- Specialiste znj. Helga Zaçe.

Të ftuarit u mirëpritën nga **Zv/ Kryetari** i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan **z. Artur Prenga** dhe **Gjyqtarja e Seksionit Penal znj. Aurora Alimadhi**. Prologu i takimit nisi me fjalën përshëndetëse të **Zv/ Kryetarit të Gjykatës z. Artur Prenga**, i cili urojë mirëseardhjen dhe vlerësoi prezencën e të ftuarve në takim. **Zv/ Kryetari i Gjykatës z. Artur Prenga** në fjalën e tij vlerësoi bashkëpunimin ndërinstitucional mes Gjykatës dhe Drejtorisë së Ndihmës Juridike të Garantuar nga Shteti.

Nga statistikat që disponojmë vihet re, një rritje e konsiderueshme e kërkesave të paraqitura në Gjykatë për përfitim të Ndihmës Juridike të Garantuar nga Shteti nga shtresat vulnerabël të shoqërisë për atë kategori personash me të ardhura të pamjaftueshme ose pa të ardhura, të moshuarit/pensionistët, personat me aftësi të kufizuar, anëtarët e komunitetit rom dhe egjiptian, viktimat e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, çka do të thotë se, personat në nevojë të Elbasanit kanë patur mundësi të mëdha për Aksesin në Drejtësi dhe përfitim të Ndihmës Juridike Parësore dhe Dytësore. Kërkesat e paraqitura vitet e fundit për marrjen e Ndihmës Juridike nga Shteti janë rritur ndjeshëm dhe fokusohen kryesisht tek kërkesat me objekt zgjidhje martesë, lëshim urdhër mbrojtjeje, përfitimet e ushqimit për fëmijët në ngarkim, njohja e viteve të punës/përfitimi i pensionit, përfitimet nga skemat e mbrojtjes shoqërore dhe çështjet e pronësisë, për rrjedhojë me rritjen e numrit të kërkesave me këtë objekt janë rritur edhe përfituesit e Ndihmës Juridike.





Përtej progresit të dukshëm në rrugëtimin e këtij projekti vihet re se, është një projekt i cili ka kaluar nëpërmjet një rrugëtimi sfidash dhe sigurisht që janë hasur problematika dhe vështirësi për të cilat mund të vijohet të punohet për përmirësim. Një prej tyre është tarifa e përcaktuar për avokatët nga Këshilli i Ministrave, tarifë e cila na pengon në gjetjen e avokatëve apo juristëve profesionistë dhe cilësorë. Fakti që përmenden problematika nuk do të thotë që nuk ka progres, pasi që është evidente që krahasuar me të mirën e përgjithshme që sjell ky projekt, dukshëm prevalon suksesi i projektit.

Në mbyllje të fjalës së tij **Zv/ Kryetari i Gjykatës z. Artur Prenga** shprehu vlerësimin e pjesëmarrjes në takim të Ambasadores së Republikës Federale të Austrisë në Shqipëri znj. Monika Zach dhe gjithë të ftuarve në këtë takim me kualitet të lartë për shkëmbim eksperiencash ndërinstitucionale.

Ambasadorja e Republikës Federale të Austrisë në Shqipëri znj. Monika Zach në fjalën e saj falenderoi **Zv/ Kryetarin e Gjykatës z. Artur Prenga** dhe të pranishmit në takim për ftesën, jam e lumtur që jam së bashku me ju në këtë takim dhe kemi mundësinë të mbështesim këtë projekt për të cilin kam dëgjuar vlerësime, vetëm pozitive.

Idea e dhënies së Ndhmës Juridike Falas është thelbësore dhe shumë e rëndësishme pëDëshiroj të theksoj se, puna që po bëjnë këshilltarët apo ndihmësit ligjor është një punë vërtet mjaft e vyer për asistimin e të gjithë personave që e kanë të nevojshme marrjen e informacionit ligjor, cka do të thotë se, pavarësisht nëse kërkesa e tyre do të përfundojë në procedura gjyqësore ose jo, ata gjithësesi kanë marrë konsulencën dhe mbështetjen e nevojshme ligjore. ofrimin e Ndhmës Juridike për shtresat në nevojë të cilët nuk kanë mundësi ta paguajnë atë, kjo është një mundësi që i ofron këtyre individëve të përfitojnë Aksesin Falas në Drejtësi.



Për sa i përket sfidave të cilat i përmendet dhe ju, por edhe ne sëbashku me njëri-tjetrin i kemi diskutuar, një prej të cilave është edhe shtrirja e madhe e këtij projekti, ndaj jemi të angazhuar për zgjidhjen e problematikave dhe jemi besimplotë që ky është një projekt i vlefshëm dhe duhet zhvillur dhe përmirësuar më tej.

Gjyqtarja znj. Aurora Alimadhi në fjalën e saj falenderoi të ftuarit dhe theksoi se, vlerëson të rëndësishme shkëmbimin e eksperiencave ndër-institucionale për përmirësimin e problematikave të caktuara për sa i takon çështjeve që lidhen me Ndhmën Juridike Falas të Garantuar nga Shteti. Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për shkak dhe të madhësisë së qarkut, ka regjistruar një numër të lartë kërkesash për Ndhmë Juridike Falas të natyrës civile dhe penale.

Vlerësoj se ky është një mekanizëm shumë eficient për të siguruar Aksesin në Gjykatë. Ky projekt i jep mundësi çdo kategorie sociale të shoqërisë të sigurojë në mënyrë profesionale Aksesin në Drejtësi dhe është një projekt i cili duhet të shtrijë fushë-veprimin e tij edhe në Gjykata të tjera të Republikës së Shqipërisë. Miratimi i Ligjit për Ndhmën Juridike të Garantuar nga Shteti në vitin 2017 na ka dhënë kohën e nevojshme për analizimin si të arritjeve, por edhe evidentimin e problematikave që mund të kenë hasur institucionet për sa i takon zbatimit të këtij Ligji.

Do e vlerësoja me interes që Drejtoria e Ndhmës Juridike si aktor kryesor në këtë projekt, të organizojë takime të tilla konstruktive në çdo Gjykatë të Republikës së Shqipërisë për të arritur në diskutimin për gjetjen e zgjidhjeve të përshtatshme të problematikave, por edhe për propozimin e ndryshimeve të nevojshme ligjore. Predispozita e Gjykatës është t'i trajtojë me objektivitet kërkesat për Ndhmën Juridike dhe t'u krijojë mundësi objektive palëve të përfitojnë Ndhmën Juridike.





Në fjalën e saj Gjyqtarja znj. Aurora Alimadhi sygjerojë bashkëpunimin dhe krijimin e një zinxhiri koordinimin të gjithë aktorëve të këtij projekti për të adresuar saktë problematikat dhe për të gjeneruar zgjidhje efçente. Procesi ka patur prosperitet dhe shpreh falenderimet e mia për mbështetjen që jepni të gjithë ju në këtë projekt.

Drejtori i Përgjithshëm i Ndhmës Juridike z. Ergys Qirici, në fjalën e tij shprehu mirënjohjen për zhvillimin e këtij takimi dhe vlerësoi se është kënaqësi të jesh pjesë e kësaj tryeze. Kur inaguruam Qendrën e Ndhmës Juridike në Elbasan në vitin 2020 nuk menduam që do të kishim këtë numër të lartë kërkesash për Ndhmë Juridike Parësore dhe Dytësore duke i mundësuar shtresave në nevojë përfaqësim profesional juridik në procese gjyqësore.

Shifrat janë impresionuese, nga Analiza Vjetore e Institucionit konstatuam se, vetëm për vitin 2024 janë regjistruar 6222 (gjashtëmijë e dyqind e njëzet e dy) qytetarë që kanë marrë në mënyrë të drejtëpërdrejtë Ndhmë Juridike Parësore, e cila mbulohet jo vetëm nga Qendrat e Ndhmës Juridike në Gjykata, por edhe nga Organizatat Jofitimprurëse dhe nga Klinikat e Ligjit. Falenderoj donatorët dhe Ministrinë e Drejtësisë të cilët kanë mbështetur në mënyrë proaktive që në fillimet e saj këte projekt.

Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan kemi 89 (tetëdhjetë e nëntë) vendime gjyqësore për Ndhmën Juridike për vitin 2024. Në lidhje me Dhomën e Avokatisë në Shqipëri, vihet re që lista ka nisur të zgjerohet. Synojmë në profilizimin e avokatëve për dhënien e Ndhmës Juridike duke mundësuar asistimin në specializim të profilizuar të tyre në çështje penale dhe civile.




Shefja e Programit të Përfshirjes Sociale në UNDP (United Nations Development Programme) znj. Entela Lako në fjalën e saj theksoi se, është privilegj që për herë të parë në këtë takim kemi të pranishme Ambasadoren e Republikës Federale të Austrisë në Shqipëri znj. Monika Zach. Nga sa u dëgjua në referimet tuaja për rritjen e numrit të personave që kanë marrë Ndihmë Juridike, ju përgëzoj për këto arritje. Është për t'u vlerësuar që brenda kësaj Gjykate janë integruar të dy format e Ndhmës Juridike asaj Parësore dhe Dytësore.

Në lidhje me problematikat mendoj se, duhen evidentuar barrierat që i shkaktojnë ato, në mënyrë që të kryhet një vlerësim i saktë për përmirësim. Dëshiroj të theksoj që programi i hartuar nga ne ka dhënë rezultate efikase në rritjen dhe forcimin e kapaciteteve të stafeve profesionale duke krijuar marrëdhënie bashkëpunimi edhe me Dhomën e Avokatisë së Shqipërisë.

Jemi të predispozuar, për të zhvilluar dhe përmirësuar punën për dhënien e Ndhmës Juridike duke shpresuar dhe në bashkëpunimin me Drejtorinë e Ndhmës Juridike dhe aktorët e tjerë të këtij projekti, për të mundësuar një akses më të madh në drejtësi për dhënien e Ndhmës Juridike Parësore dhe Dytësore, për një drejtësi të drejtë, të shpejtë dhe me sa më shumë rezultate pozitive me rritje progresive.

Në mbyllje të takimit, të ftuarit falenderuan Zv/ Kryetarin e Gjykatës z. Artur Prenga për mirëpritjen dhe vijuan vizitën e tyre në ambientet e Qendrës së Ndhmës Juridike që gjendet si pjesë integrale në strukturën e brendshme të godinës së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.






TAKIM NDËRINSTITUCIONAL ME STUDENTË TË FAKULTETIT TË BIZENISIT DHE DREJTËSISË TË UNIVERSITETIT “ALEKSANDËR XHUVANI” DHE SHKOLLËS SË MESME “MEDRESE LIRA” ELBASAN

Sot, më datë **28.03.2025**, me studentë të Fakultetit të Biznesit dhe Drejtësisë të Universitetit “Aleksandër Xhuvani” vizituam klasën e 10-të dhe 11-të, të shkollës “Medrese Liria” Elbasan. Takimi u realizua në kuadër të projektit të nisur në Dhjetor 2024, me synimin për zhvillimin e aktiviteteve me objekt “Këshillim karriere, sensibilizim dhe njohje e të miturve me kuadrin ligjor të drejtësisë për të mitur”, projekt i cili u mbështet dhe u formalizua me asistimin dhe qëllimin për të patur një shtrirje më të gjërë në disa institucione edhe jashtë Gjykatës nga Zv/ Kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan z. Artur Prenga dhe Gjyqtari i Medias z. Ardit Kuka.

Ky projekt vijoi sot më datë 28.03.2025 me shkollën “Medrese Liria” Elbasan me bashkëpunimin proaktiv të Psikologes Klinike **znj. TIRE KAMBERI** dhe Drejtuesit të shkollës të “Medrese Liria” **z. Daniel Çela**, të cilët mundësuan akesin dhe pritjen në shkollën “Medrese Liria” Elbasan. Vlerësojmë shumë impenjimin dinjitoz të grupit të studentëve; **Anjeza Cerriku, Teuta Debrova, Klejt Tollumi, Klajdi Hoxha**, të cilët referuan për nxënësit materiale bazuar në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur, rastet praktike të situatave të ndryshme konfliktuale në mënyrë që të miturit të ndërjegjësohen për mënyrat se si duhet të sillen kur hasen dhe bien ndesh me këto raste konfliktuale, ku duhet të adresojnë shqetësimin e tyre për zgjidhje, rëndësisë që duhet t'i japin veprimeve dhe mosveprimeve të tyre në lidhje me këto situata në ambientet e shkollës dhe jashtë saj, për të mos u bërë subjekte të kryerjes së veprave penale apo viktimë e veprave penale, për të njohur vlerën e asaj që është më e shtrenjtë për individin në çdo shoqëri: jetesën në një shoqëri tolerante, të drejtë dhe të jetuarit të lirë.





Referuan mbi qëllimin e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, konceptin juridik të subjekteve të Drejtësisë Penale për të Mitur, prezumimin e pafajësisë, parimin e interesit më të lartë të fëmijës, moshja për përgjegjësi penale, të drejtat e të miturit në konflikt me ligjin, të drejtat e të miturit viktimë, vendosja e të miturit në mbikqyrje, pjesëmarrja në gjykim e të miturit, masat e dënimit, kryerja e një pune me interes publik, Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale për të Mitur në Konflikt me Ligjin etj.

Mesazhi që studentët përçuan tek të miturit ishte motivimi i tyre për shmangie të çdo situatë konfliktuale dhe adresimi i çdo shqetësimi tek institucionet përkatëse si: psikologu i shkollës, prindi dhe/ose kujdestari ligjor i të miturit, Instancat Shtetërore kompetente si, Policia e Shtetit dhe Prokuroria.


Në këtë aktivitet referuam gjithashtu për nxënësit informacion mbi:

- Infrastrukturën e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.
- Strukturat e tjera në kompetencën tokësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.
- Njohjen dhe prezantimin me shkallët e gjyqësorit.
- Njohjen dhe informimin mbi format e aksesimit të faqes zyrtare të www.gjykata.gov.al.
- Njohjen dhe informimin mbi rubrikat njoftuese të faqes zyrtare, mënyra e kërimit të informacionit, depozitimi i kërkesave në gjykatë, njohja me veprimtarinë e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.



Falenderojmë Drejtuesin e Institucionit Arsimor z. Daniel Çela dhe znj. Tire Kamberi të cilët mundësuan pritjen dhe mjetet teknike për një prezantim të plotë, efikas dhe në kohë reale nëpërmjet pajisjeve përkatëse për një paraqitje dhe prezantimin të plotë dhe akses të drejtëpërdrejtë të faqes zyrtare www.gjykata.gov.al, si edhe informacionit të posaçëm të rubrikave informuese të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Në finalizim të këtij projekti **studentët janë certifikuar më datë 29.05.2025** për kontributin e tyre në këtë projekt informues dhe këshillues të kuadrit ligjor për të miturit.



GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM ELBASAN



Më datë **15.04.2025**, Zv/Kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan **z. Artur Prenga**, prezantoi përpara Trupës Gjyqësore të kësaj Gjykate, si dhe të ftuarve pjesëmarrës në takim “Analizën e Punës për Vitin 2024”.

Të ftuar në takim:

- Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor **Prof. Asoc. Dr. z. Ilir Rusi**;
- Inspektori i Lartë i Drejtësisë **z. Artur Metani**;
- Këshilltare, Antare e Kabinetit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë **znj. Arjeta Lika**;
- Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan **z. Kreshnik Ajazi**;
- Zv/ Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan **z. Xheljan Seferi**;
- Drejtuese e Seksionit Penal për të Mitur të Ekzekutimit të Vendimeve Penale dhe Marrëdhëniet Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan **znj. Glenda Zeneli**;
- Drejtuese e Seksionit të Drejtësisë Penale, Seksioni i Posaçëm Kundër Pastrimit të Parave, Krimeve Financiare, Financimin e Terrorizmit dhe Hetimet Pasurore **znj. Edlira Bako**.

GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM ELBASAN



Prologu i takimit nis me fjalën përshëndetëse të Zv/Kryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan **z. Artur Prenga**, i cili falenderoi të ftuarit për pjesëmarrjen e tyre në këtë takim.

Zv/Kryetarit i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan **z. Artur Prenga**, falenderoi Këshillin e Lartë Gjyqësor për mbështetjen e vazhdueshme financiare në përmirësimin e infrastrukturës, për kërkesat e paraqitura në lidhje me shtimin e burimeve njerëzore të stafit mbështetës të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, si edhe shtimin e organikës së Trupës Gjyqësore të kësaj Gjykate.

Zv/ Kryetari i Gjykatës **z. Artur Prenga** në fjalën e tij vlerësoi punën dhe angazhimin profesional të Trupës Gjyqësore gjatë Vitit 2024, fokusi dhe angazhimi i të cilës ka qenë i përqëndruar në uljen e numrit të BackLog-ut të çështjeve të kësaj Gjykate. Zv/Kryetari i Gjykatës **z. Artur Prenga** në fjalën e tij shprehu falenderimet për bashkëpunimin e frytshëm në arritjen e rezultateve të përmirësuar, Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe gjithë bashkëpunëtorët në këtë proces të rëndësishëm të dhënies së drejtësisë.

GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM ELBASAN



Në vijim të takimit Zv/Kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan **z. Artur Prenga** paraqiti për pjesëmarresit një panoramë përmbledhëse të punës së Gjykatës për Vitin kalendarik 2024.

Gjatë relatimit të kësaj analize Zv/ Kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan **z. Artur Prenga** trajtojë në terma shtejllues dhe përcaktues, treguesit që lidhen me: ngarkesën dhe llojin e çështjeve gjyqësore, tendencat e ngarkesës me çështje, ngarkesat me çështje për gjyqtar, treguesit e performancës së gjyqtarëve në menaxhim dhe në vendimmarrje,

menaxhimin e lëvizjes së çështjeve gjyqësore, si edhe tregues që lidhen me performancën e punës së administratës së Gjykatës, organikën dhe burimet njerëzore, performancën dhe funksionimin e Këshillit të Gjykatës, burimet materiale, performancën e ofrimit të shërbimeve të gjykatës, aksesit, transparenca, marrëdhëniet me publikun dhe median, çështje të infrastrukturës, ruajtjes dhe sigurisë në gjykatë, administrimi i fondeve publike, marrëdhëniet dhe marrëveshjet ndërinstitucionale gjatë këtij viti. Të gjithë këto komponentë, të cilat në tërësi janë elementë dhe tregues që vlerësohen të kenë ndikim në performancën e përgjithshme të punës dhe veprimtarisë së kësaj Gjykatate.

GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM ELBASAN



Inspektori i Lartë i Drejtësisë **z. Artur Metani** në fjalën e tij shprehu se: “Vlerësoj ftesën për pjesëmarrje në këtë Analizë Pune të Vitit 2024, sepse Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan është një nga Gjykatat më të rëndësishme në Republikën e Shqipërisë për nga numri i lartë i çështjeve për gjykim. Pjesëmarrja në Analizën e Punës së Vitit 2024, është edhe për faktin se dëshiroj të shoh nga afër dinamikat dhe problematikat që hasin gjykatat në punën e tyre, në mënyrë që të arrijmë rezultate të përmirësuara në vijim.

Dëshiroj të theksoj se, koordinimi me një gjuhë vlerash ndërmjet institucioneve do të sjellë efikasitetin e strukturave, ndaj dhe jemi këtu bashkë për të dëgjuar problematikat, shqetësimet dhe vështirësitë tuaja në këtë proces, në mënyrë që të koordinojmë punën tonë në një emërues të përbashkët të një gjuhe vlerash. Jam i mendimit se, vështirësia në këtë proces është e njëjtë për të gjithë strukturat e drejtësisë. Jemi të prirur të mirëkuptojmë vështirësitë dhe kompleksitetin e situatave të vështira me të cilën po përballen puna e gjykatave të Republikës së Shqipërisë në këtë periudhë kohe, për shkak të ngarkesës së lartë të çështjeve për gjykim. E rëndësishme në këtë proces kompleks, është që magistratët të tregojnë përkushtim në punën e tyre dhe të mirë- menaxhojnë çështjet gjyqësore me të gjithë mundësitë që kanë, gjithnjë në respekt dhe zbatim të legjitimitetit të trajtimit dhe gjyqimit të tyre.”

GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM ELBASAN



Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. **Artur Metani**, shprehu falenderimet e tij për të gjithë strukturat e sistemit të drejtësisë dhe Këshillin e Lartë Gjyqësor, për bashkëpunimin ndërmjet tyre dhe theksoi se, “Ngarkesa në këtë proces dhe rrugëtim të drejtësisë nuk është vetëm e gjykatave, por e gjithë strukturave që janë pjesë e Reformës në Drejtësi, reformë e cila bëri të mundur dhe krijimin e arkitekturës së Organeve të Drejtësië. Kuptojmë punën dhe ngarkesën e secilit por vlerësoj se, funksioni i detyrës së gjyqtarit duhet të shihet nga ju si **“Dhunti që buron nga shpirti, sepse të japësh drejtësi është një mision”**. E rëndësishme në procesin e Reformës në Drejtësi është që institucionet duhet të flasin të njëjtën gjuhë vlerash për të qenë bashkë në arritjen e rezultateve me efikasitet të plotë të Reformës në Drejtësi.”

GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM ELBASAN

Drejtuesi i Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan **z. Kreshnik Ajazi** në fjalën e tij shpehu se: “Dëshiroj t’i përcjell për-gëzimet e mia Trupës Gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për punën e bërë, sfidat nëpër të cilat keni kaluar, ngarkesën e përballuar nga ana e të gjithë Trupës Gjyqësore të kësaj Gjykate. Është për t’u vlerësuar fakti se, në mënyrë të vazhdueshme kemi ndërtuar një frymë komunikimi të ndër-sjelltë me të gjithë Trupën Gjyqësore dhe specifikisht me Zv.Kryetarin e kësaj Gjykate **z. Artur Prenga** për koordinimin e punës mes dy institucioneve në aspektin administrativ. Kemi gjetur mirëkuptimin e plotë nga ana e Gjykatës për kërkesat e natyrës së ngutshme që kanë të bëjnë me Fazën e Hetimeve Praraprake.



Jemi përpjekur që sygjerimet problematikat e ngritura nga ana e Trupës Gjyqësore, apo të adresuara nga Zv. Kryetari i Gjykatës **z. Artur Prenga**, t’i reflektojmë në përmirësimin e veprimtarisë tonë administrative dhe procedurale, t’ia përcjellim këto sygjerime dhe problematika prokurorëve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, në mënyrë që të krijojmë një qasje kohezive për administrimin e institucionet tona. Kërkojmë mirëkuptimin nga ana e Gjykatës, sepse Viti 2024 për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan gjithashtu, ka qenë një vit i vështirë për shkak të vakancave të krijuara, organika e të cilës po vjen duke u përmirësuar me plotësimin e vazhdueshëm të vakancave të krijuara për shkak të procesit të rivlerësimit, kalimit të përhershëm apo të përkohshëm të prokurorëve. Ju falenderoj për ftesën dhe vlerësoj bashkëpunimin e frytshëm mes institucioneve për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së punës së institucioneve që përfaqësojmë.”

GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM ELBASAN



Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor Prof. Asoc. Dr. z. **Ilir Rusi** në fjalën e tij u shpreh se: “Për shkak të pjesëmarrjes në shumë Analiza të Punës për Vitin 2024 të gjykatave të Republikës së Shqipërisë, dëshiroj që diskursi të mos kalojë në përsëritje, por të evidentojmë treguesit që tregojnë rritje të përmirësimit të punës. Ky vit, ka qenë një vit dinamik dhe me ndryshime të vazhdueshme. Procesi i rivlerësimit të gjyqtarëve, kalimit të përkohshëm dhe të përhershëm, si edhe promovimi i gjyqtarëve, ka krijuar një situatë të re për mungesat dhe plotësimin e organikës së plotë të gjykatave. Por pjesëmarrja e Këshillit të Lartë Gjyqësor në Analiza Pune të gjykatave, është për të dëgjuar jo vetëm rezultatet e arritura të punës, por jemi prezentë në këto takime për të dëgjuar edhe problematikat e hasura dhe reflektimim për marrjen e masave për përmirësim të tyre.

Besoj dhe shpresoj që magjistratët e emëruar do të sjellin ndryshime dhe përmirësime të mëtijshme të performacës jo vetëm të kësaj Gjykate, por dhe sistemit të drejtësisë në terësi dhe se gjithashtu do të vijojnë të ruajnë ritme të kënaqshme pune. Mendoj se, është për t'u vlerësuar fakti se nga të dhënat e paraqitura, reflektohen tregues të tillë që diktojnë se përafërsisht në këtë Gjykatë përfundojnë shqyrtimin gjyqësor gati 2 (dy) çështje në ditë për gjyqtar, referuar treguesve të statistikave të çështjeve të përfunduara. Në fakt vërehet se, tregues të mirë të rezultateve të arritura kanë reflektuar përgjithësisht të gjitha Gjykatat e Shkallëve të Para të Republikës së Shqipërisë. Këshilli i Lartë Gjyqësor ndjek me interes Analizat e Punës së gjykatave dhe vlerësojmë se jemi në një situatë komplekse, por ajo që në fund kërkojmë dhe synojmë të arrijmë është që shtetasit shqiptar të përfshirë në procese gjyqësore të marrin drejtësi. Procesi i Reformës në Drejtësi është një marrëdhënie që duhet parë në kompleksitet, një marrëdhënie kolegjaliteti dhe bashkëpunimi ndërmjet të gjithë Organeve të Drejtësisë, si një zinxhir ku secili duhet të kryejë detyrat e tij për të arritur rezultatet e shumëpritura.

GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM ELBASAN



Këshilli i Lartë Gjyqësor ka marrë masa organizative dhe administrative në mënyrë të vazhdueshme, në përditshmëri, në lidhje me zgjidhjen e problematikave të infrastrukturës, rritjes së burimeve financiare, burimeve njerëzore të cilat të gjitha së bashku shërbejnë për një qëllim final, për t'i ofruar qytetarëve shërbime efikase. Vëmendja jonë e shtuar për çdo gjykatë është jo vetëm në përmirësimin e masave administrative, por edhe sa i takon atyre që lidhen me prioritetet dhe objektivat për realizim, sikurse edhe për këtë Gjykatë, duke synuar angazhimin e vazhdueshëm për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe dhënies së drejtësisë. Jemi besimplotë në përmirësimin sa më të shpejtë dhe të vazhdueshëm të modernizimit të Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore, i cili do të jetë hapi ynë i ardhshëm drejt finalizimit të Dosjes Dixhitale, e cila do të rrisë jo vetëm aksesin, por dhe përmirësimin e shërbimeve për qytetarët, duke bërë që **koha të marrë kështu vlerën e saj reale** me përmirësimin e efikasitetit të marrjes së shërbimit nga qytetarët. **Falenderimi është për ju, por dhe për të gjithë ata, të cilët sadopak ndikojnë për të rritur dhe përmirësuar performancën e dhënies së shërbimit ndaj qytetarëve.**

GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM ELBASAN



Takimi vijojë me diskutim mes Trupës Gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe pjesëmarrësve në këtë takim, mbi problematikat që hasen në praktikë gjatë procesit të punës dhe masat e marra për përmirësim. Çështje me rëndësi që u shtrua për diskutim, ishte kërkesa për rritjen e numrit të Ndhimësve Ligjorë që do të ndikojnë në zbtujen e numrit të BackLog-ut të çështjeve gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe jo vetëm.

Në mbyllje të takimit, Zv. Kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan z. **Artur Prenga**, falenderoi pjesëmarrësit për prezencën e tyre në këtë takim dhe angazhimin e tyre në përmirësimin e performacës së punës së gjyqësorit në tërësi.




SIMPOZIUMI I KARRIERËS DHE AFTËSIVE NË UNIVERSITETIN “ALEKSANDËR XHUVANI”

Më datë **29 Prill 2025** Zv/Kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan **z. Artur Prenga** mori pjesë si i ftuar i Sesionit të Drejtësisë në Simpoziun e Karrierës dhe Aftësive në Universitetin “Aleksandër Xhuvani”, i cili organizoi Konferencën e 4-të Ndërkombëtare Studentore.

Përmes këtij sesi interaktiv, **z. Artur Prenga** në këtë seancë frymëzojë dhe udhëzojë studentët në ndërtimin e një karriere në fushën e së drejtës duke prezantuar për studentët:

- Metodat e Planifikimit të Karrierës;
- Institucionet e Drejtësisë në Republikën e Shqipërisë;
- Risitë e Reformës në Drejtësi;
- Profesionet me Projektion Fushën e së Drejtës;
- Roli i Shkollës së Magjistraturës në zhvillimin e karrierës si Magjistrat;
- Ndërveprimi Institucional me studentë të praktikave mësimore;
- Marrëveshja Internship, mundësitë, të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin prej saj.





Në fjalën e tij Zv/ Kryetari z. Artur Prenga u shpreh se: “Doja të nisja këtë bisedë me ju duke ju parashtruar se, karriera nuk është vetëm një profesion apo punë e paguar. Karriera është e gjithë puna produktive, e paguar dhe e papaguar, e kryer gjatë gjithë jetës së një individi.

Planifikimi i karrierës është një proces i përjetshëm, që fokusohet në vendimmarrjet tuaja për të bërë zgjedhjet e duhura që do t’iu ndihmojnë të menaxhoni punën tuaj dhe jetën personale.

Në këtë fazë të ciklit të jetës tuaj, duhet të konsideroni të rëndësishme që të kryeni një orientim dhe planifikim të mirë të karrierës, por ky proces kërkon informacion rreth jush, rreth botës së punës dhe angazhimit që duhet të keni.

Për të qenë të suksesshëm si edhe shprehej filozofi Kinez duhet të ndërgjegjësoheni se, “Vullneti për të fituar, dëshira për sukses, kërkojnë arritjen e zhvillimit të potencialit tuaj të plotë këto janë çelësat që do t’iu hapin derën e përsosmërisë personale”.

Dhe në jetë si edhe shprehet Albert Einstein “Mos syno të jesh i suksesshëm por të jesh i vlefshëm.” Nëse je i vlefshëm suksesi në karrierën dhe rrjedhimisht në jetën tuaj do të jetë gjithnjë dhe më i prekshëm.

Magjistrati Italian Giovanni Falcone shprehet se: “Kam evituar përherë të marr iniciativë që nuk kishin ndonjë mundësi të arsyeshme suksesi!”



JAVA E DREJTËSISË

GJYQ IMITUES ME STUDENTË TË UNIVERSITETIT “ALEKSANDËR XHUVANI”

Në kuadër të Javës së Drejtësisë që kulmon me datën 10 maj, Ditën e Drejtësisë në kujtesë të Kanonit të Zhurisë 10 maj 1913 kur Shqipëria shtronte hapat e parë drejt krijimit të organeve kryesore të pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor të shtetit të ri të sapo krijuar.

Në kuadër të Javës së Drejtësisë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan një grup studentësh të Fakultetit të Biznesit dhe Drejtësisë në Departamentin e të Drejtës të Universitetit "Aleksandër Xhuvani" të cilët ndjekin praktikat mësimore në këtë Gjykatë në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit mes institucioneve, zhvilluan sot më datë **07.05.2025** seancë gjyqësore imituese, të realizuar me të gjithë komponentët përbërës të një seance gjyqësore.

Studentët gjatë kësaj periudhe janë asistuar nga Trupa Gjyqësore e kësaj gjykate, duke u mundësuar të ndjekin një numër të konsiderueshëm seancash gjyqësore nga Seksioni Penal dhe Seksioni Civil.

Sot më datë 07.05.2025 studentëve iu dha mundësia të vendosin në praktikë njohuritë e marra gjatë kësaj periudhe praktike nga Trupat Gjyqësore.

Seanca gjyqësore civile me objekt: “Detyrimin e të paditurve, të njohin paditësin pronar me parashkim fitues mbi pasuritë e paluajtshme; Konstatimi i pavlefshmërisë absolute (të pjesshme) të kontratës; Fshirjen e hipotekës së vendosur në favor të palës së paditur”.





Baza Ligjore: “Neni 31, 32, 154 i Kodit të Procedurës Civile, neni 168, 170, 304, 306, 92/a, 566, 572, 584 i Kodit Civil”, u realizua nga:

Trup gjykues i përbërë nga:

- Entugena Karamuca në rolin e Gjyqtarit Kryesues;
- Desentila Lena në rolin Gjyqtare Anëtare;
- Ira Sinani në rolin e Gjyqtare Anëtare.

Role të tjera të seancës gjyqësore u interpretuan nga:

- Sekretare Gjyqësore- Esmeralda Sollaku;
- Palë Paditëse- Marin Agolli;
- Avokatët e Paditësit: Gloria Lleshanaku , Ana Toçi;
- Palë e Paditur: Fjorela Kasa;
- Avokate e Bankës X - Geserina Tafa;
- Administratore e Shoqërisë S.- Rexhina Koci;
- Eksperte Ing. Topografe- Rosela Lami.

Faleminderit studentëve të Fakultetit të Biznesit dhe Drejtësisë, për kontributin, përkushtimin, si edhe seriozitetin e realizimit të detyrave të caktuara.

Seanca gjyqësore u zhvillua në prani të gazetarit të **RTSH Radio Televizioni Shqiptar z. Enes Molla** të cilin e falenderojmë për bashkëpunimin e vazhdueshëm.

-Gjyqtarëve znj. Suela Lika dhe gjyqtar z. Ardit Kuka për suportin e përgatitjeve të materialeve të seancave gjyqësore;





Falenderime dhe mirënjohje për të gjithë suportuesit e projektit që mundësuan realizimin e aktivitetit me natyrë edukative për studentët.

- Gjyqtarëve: z. Elis Dine, gjyqtar z. Ardit Kuka dhe sekretare znj. Erisa Çili që suportuan studentët me Togat;
- Prof.as.dr Arber Gjeta dhe Avokat Dylber Dervishi për veshjet e avokatit;
- Trupën Gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për aksesin e vazhdueshëm të krijuar për ndjekjen e seancave gjyqësore;
- Gjyqtare znj. Aurora Alimadhi për krijimin e mundësisë së aksesit të zhvillimit të seancës gjyqësore sot më datë 07.05.2025;
- Zv/ Kryetarin e Gjykatës z. Artur Prenga për lejimin e aksesit të studentëve në Gjykatë dhe suportimin e këtyre aktiviteteve edukative dhe informuese për të rinjtë, nëpërmjet krijimit të bashkëpunimeve me Institucionet e Larta Arsimore;
- Të gjithë studentët e praktikave mësimore të Universitetit "Aleksandër Xhuvani" për angazhimin e tyre.

Në finalizim të këtij projekti **studentët janë certifikuar më datë 29.05.2025** për kontributin e tyre në këtë projekt.



JAVA E DREJTËSISË SHKOLLA E MESME MEDRESE LIRIA

Në kuadër të Javës së Drejtësisë dhe bashkëpunimeve me Institucione Arsimore për zhvillime të aktiviteteve edukative në përputhje me kurrikulat mësimore për zhvillim karriere, sot, më datë **09.05.2025**, miqtë tanë të vegjël të Shkollës së Mesme “Medrese Lira” në Elbasan, vizituan Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Në këtë vizitë nxënësit u njohën me:

- Kuptimin e datës 10 maj 1913, Ditën Kombëtare të Drejtësisë, që shënon Aktin e Parë Juridik “Kanuni i Zhurisë”;
- U njohën me ambientet e brendshme të Gjykatës, Zyrat e Shërbimit, Funkcionet e Nëpunësve, Funkcionet e Trupës Gjyqësore;
- Morën njohuri në lidhje për projektimim e zhvillimit të karrierës së tyre, për procedurat që ndiqen për të ushtruar një nga profesionet e nderuara të fushës së drejtësisë si: Jurist, Avokat, Noter, Përmbarues, Ndërmjetësues, Këshilltar Ligjor, Kancelar, Magjistrat etj.;
- Nxënësit u udhëhoqën gjatë kësaj periudhe për të ndërtuar një gjyq imitues asistuar nga mësuesja e tyre znj. Tire Kamberi;
- Në kuadër të Javës së Drejtësisë nxënëset e Shkollës së Mesme Medrese Liria paraqitën në Ambientet e Gjykatës punimet në pikturë dhe argjilë të shoqëruara me ese të shkurtra shpjeguese të punimeve të tyre;
- Engelin Zogu vendi i I (parë) në skulpturë;
- dhe Esmeralda Maxhari vendi i I (parë) në pikturë, në konkursin e zhvilluar nga ZVA Elbasan “16 ditë të Aktivizimit kundër Dhunës me Bazë Gjinore” me pjesmarrjen e shkollave të mesme të qytetit;



- Piktura e realizuar nga Esmeralda Maxhari me titull “Gruaja mes Dritës dhe Hijes – Një Luftë për të Drejtat”;
- Punimi në argjilë realizuar nga Engelin Zogu Barazia gjinore: “Të drejtat e grave, të drejtat e njeriut”.

Falenderime dhe mirënjohje për të gjithë suportuesit e projektit që mundësuan realizimin e aktivitetit me natyrë edukative për nxënësit.

- Zv/ Kryetarin e Gjykatës z. Artur Prenga për lejin e aksesit të nxënësve në Gjykatë dhe suportimin e këtyre aktiviteteve edukative dhe informuese për të rinjtë me synimin për të sjellë një Gjykatë të Hapur dhe të aksesueshme për çdo grup interesi;
- Gjyqtar z. Ardit Kuka dhe sekretare znj. Erisa Çili që suportuan nxënësit me Togat;
- Nxënësit e Shkollës së Mesme Medrese Lira për përgatitjen dhe impenjimin e tyre;
- Mësuesen e Shkollës së Mesme Medrese Liria që mbështet dhe udhëzon nxënësit në këto projekte edukative;
- Gjyqtarëve znj. Suela Lika dhe gjyqtar z. Ardit Kuka për suportin e përgatitjeve të materialeve të seancave gjyqësore;
- Studenten e praktikave mësimore të Universitetit “Aleksandër Xhuvani” znj. Esmeralda Sollaku për kontributin e saj me përkushtim dhe pasion për pasqyrimin e aktivitetit.

Në këtë aktivitet është konsideruar e drejta për publikim dhe fotografim të nxënësve nëpërmjet "Lejes Prindërore" të depozituar nga Institucioni Arsimor.

Aktiviteti u zhvillua me kërkesë të Institucionit Arsimor “Medrese Liria”, përfaqësuar nga znj. Tire Kamberi dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.



JAVA E DREJTËSISË



PUNOI

© ESMERALDA MAXHARI

Shkolla: Medrese "Liria"

Piktura e realizuar nga Esmeralda Maxhari me titull: "Gruaja mes Dritës dhe Hijes – Një Luftë për të Drejtat Themelore".

Esmeralda Maxhari, përçon ndjesitë e saj nëpërmjet kësaj eseje për pikturën e realizuar prej saj:

Të drejtat e njeriut janë shtylla themelore mbi të cilat ngrihet një shoqëri e drejtë dhe e barabartë. Ndër këto, të drejtat e gruas zënë një vend thelbësor, pasi historikisht ajo ka qenë e nënshtruar dhe e perjashtuar në shumë kultura e shoqëri. Piktura në fjalë është një pasqyrë simbolike e kësaj lufte që gratë zhvillojnë për të drejtat e tyre, duke u përballur me padrejtësi, por edhe duke shpresuar dhe luftuar për çlirim dhe barazi. Figura qendrore e imazhit është gruaja, e cila qëndron e kthyer nga drita, me zinxhirë që po çkyçen prej trupit të saj. Zinxhirët përfaqësojnë kufizimet e shumta të vendosura ndaj grave në histori: ndalimi i arsimit, përfshirja e kufizuar në vendimmarrje, mungesa e të drejtës për trashëgimi, dhe dhuna fizike e psikologjike. Akti i thyerjes së zinxhirëve është metaforë e fuqishme e çlirimit, e emancipimit, dhe e fuqizimit personal e kolektiv të gruas.

Ngjyrat dhe ndarja mes dritës dhe errësirës në sfondin e pikturës nënvizojnë kontrastin mes shtypjes dhe shpresës. Ana e majtë me ngjyra të zjarra mund të simbolizojë dhunën, nënshtrimin, dhe trazirat, ndërsa ana e djathtë me ngjyra të ftohta e qiellore mund të shihet si simbol i drejtësisë, paqes dhe mundësisë së zhvillimit. Gruaja qëndron në mes, duke kaluar nga një e kaluar e errët drejt një të ardhmeje të ndriçuar. Peshorja, një simbol i paanshmërisë dhe ekuilibrit të të drejtave dhe librat e hapur janë simbole të drejtësisë dhe dijes. Pa drejtësi, nuk ka barazi; pa dije, nuk ka vetëdije. Peshorja është shpesh simbol i ligjit dhe barazisë para tij, dhe prania e saj në të dy anët tregon se drejtësia duhet të jetë universale. Librat simbolizojnë dijen si armë kundër shtypjes dhe si mjet çlirimi intelektual.

Ky imazh mund të interpretohet si një përfaqësim i fuqishëm i forcës së gruas, aspiratës për drejtësi dhe lirisë nga kufizimet. Ai mund të shërbejë si një simbol i shpresës dhe inkurajimit për të vazhduar luftën për të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore.

Ky imazh është më tepër se një pikturë artistike; ai është një thirrje në vetëdije, një reflektim i thellë mbi rrugëtimin e gruas drejt barazisë dhe lirisë. Të drejtat e njeriut nuk mund të konsiderohen të plota pa garantimin e të drejtave të gruas. Ndërsa shoqëritë zhvillohen, duhet të sigurohemi që kjo figurë qendrore – gruaja – të mos jetë më e lidhur me zinxhirë, por e lirë, e ditur dhe e respektuar. Vetëm atëherë mund të flasim për një shoqëri vërtet humane dhe të drejtë.

Faleminderit Esmeralda Maxhari për impenjimin tënd në këtë projekt, për mëndjen e ndritur dhe duart e arta!

JAVA E DREJTËSISË



PUNOI
© Engelin Zogu
Shkolla: Medrese “Liria”

Punimi në argjilë i realizuar nga Engelin Zogu me titull: Barazia gjinore: “Të drejtat e grave, të drejtat e njeriut”.

Engelin na përçon ndjesinë e saj në realizimin e këtij punimi në argjilë duke na e përshkruar:

“Një shpirt që çlirohet, një grua që ngrihet — kjo vepër me argjilë mishëron fuqinë e shpresës dhe të drejtësisë. Flatrat e arta flasin për triumfin mbi pengesat, ndërsa forma e brishtë dhe elegante përkujton forcën e heshtur të grave në luftën për barazi dhe dinjitet. Si një himn për të drejtat e njeriut, kjo krijesë shndrit të vërtetën se çdo qenie lind për të fluturuar, e lirë nga prangat e padrejtësisë. Çdo vijë, çdo teksturë është një thirrje për ta parë botën me sytë e barazisë dhe të dashurisë njerëzore.”

Faleminderit Engelin Zogu për impenjimin tënd në këtë projekt, për mendjen e ndritur dhe duart e arta!



JAVA E DREJTËSISË LEKSION I HAPUR NË UNIVERSITETIN “ALEKSANDËR XHUVANI”

Në kuadër të Javës së Drejtësisë, në zbatim të Vendim Nr. 590 datë 26.11.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me objektivin 5.4 për të sjellë Gjykatën më afër komunitetit, më datë **12.05.2025** në bashkëpunim me Universitetin “Aleksandër Xhuvani”, magjistratët **z. Ardit Kuka**, **z. Elis Dine** dhe **z. Gjergji Baçi** zhvilluan leksion të hapur me studentë të Fakultetit të Biznesit dhe Drejtësisë të Universitetit “Aleksandër Xhuvani”, workshop me temë “Java e Drejtësisë”.

Gjyqtarët u mirëpritën nga:

- Prof.as.dr. Arbër Gjeta- Përgjegjës i Departamentit të së Drejtës, Fakulteti i Biznesit dhe i Drejtësisë,
- Prof.as.dr. Shpëtim Çerri- Dekan i Fakultetit të Biznesit dhe Drejtësisë.

Gjyqtar **z. Ardit Kuka** referojë për studentët tematikën mbi “Shtetin e së Drejtës dhe Sfidat e Tij” duke u ndalur në:

- Vështrimin historik të Mendimit Politik Grek, e Drejta Romake e cila sanksionoi epërsinë e normës juridike në shtet, Revolucioni i Lavdishëm Anglez (1688), Revolucioni Francez (1789-1793);
- Në kërkim të një përkufizimi të shtetit juridik apo shtetit të së drejtës, nën këndvështrimin e tre aspekteve formal, doktrinor dhe material;
- Deklaratën e të Drejtave të Njeriut dhe Qytetarit, Francë (1789);
- Shkolla Juridike Gjermane me teorinë e vetëkufizimit juridik të shtetit nga Ihering dhe Jelinek;





- Hans Kelsen me konceptin formal juridik;
- Nenet 4,7,122,124 të Kushtetutës që sanksionojnë parimet e shtetit të së drejtës.
- Tiparet e shtetit të së drejtës etj.

Gjyqtar **z. Elis Dine** referojë për studentët “Konceptin e të Drejtës për t’u Harruar nga Subjekti i të Dhënave”, e drejta për të kërkuar fshirjen e të dhënave personale që e identifikojnë atë;

- Si lind e drejta për t’u harruar;
- Vendimi i GJED për rastin “Google Spain Sl, Google Inc. kundër Agjencisë Spanjolle (AEDP) dhe Mario Costeja Gonzales”;
- Kritikat ndaj vendimit;
- Diskutim me studentët: mbi të drejtën për t’u harruar në raport me të drejta të tjera(si ajo për t’u informuar);
- Rregullorja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave 2016/679 (GDPR), neni 17 i GDPR;
- Legjislacioni shqiptar Ligj nr. 124/2024;
- Rastet e fshirjes sipas Nenit 15. të Ligj 124/2024;
- Operatorët e Kërkimit;
- Sanksionet.

Gjyqtar **z. Gjergji Baçi** referojë për studentët “Amendamentet Kushtetuese dhe Paketa Ligjore lidhur me Funkcionin e Klgj-së”;

- Përbërja dhe organizimi i Klgj-së;
- Emërimi i anëtarëve të KLGJ-së
- Roli i Ministrisë së Drejtësisë;
- Kompetencat e KLGJ-së;





Gjiqtar i Medias
z. Ardit Kuka



Gjiqtar
z. Elis Dine



Gjiqtar
z. Gjergji Baçi

Duke arritur në përfundimin se, paketa kushtetuese dhe ligjore e miratuar në kuadër të reformimit të sistemit të drejtësisë lidhur me përbërjen, mënyrën e emërimit të anëtarëve, përgjegjësitë dhe mënyrën e funksionimit të KLGJ-së, i përgjigjen nevojave të kohës në mënyrë që të garantohet pavarësia, përgjegjshmëria, cilësia, përbërja dhe efienca e këtij organi të rëndësishëm kushtetues dhe përmes tij të garantohet mirëqeverisja dhe pavarësia e gjyqësorit, si dhe statusi dhe paannësia e gjyqtarëve.

Takimi u mbyll me një diskutim të lirë pyetje-përgjigje ndërmjet studentëve drejtuar gjyqtarëve.

Falenderime dhe mirënjohje për:

-Gjiqtarët: z. Ardit Kuka, z. Elis Dine, z. Gjergji Baçi, për pjesëmarrjen dhe impenjimin e tyre duke sjellë përpara studentëve referime profesionale në fushën e së drejtës.

-Rektoren e Universitetit “Aleksandër Xhuvani” Prof.dr. znj. Elvira Fetahu dhe Zv/ Kryetarin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan z. Artur Prenga për krijimin e mundësive të ndërveprimit institucional në zhvillimin e aktiviteteve informuese dhe ndërgjegjësuere për studentët, në përputhje me objektivin Nr. 5.4 të “Planit Strategjik të Komunikimit” për krijimin e bashkëpunimit me Fakultet e Drejtësisë.

Faleminderit znj. Besa Kozaria-Përgjegjëse Sektori e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit për përkushtimin dhe mbështetjen në organizimin e workshop-it dhe znj. Erisa Avdiaj-Specialiste Komunikimi në Universitetin “Aleksandër Xhuvani” për pasqyrimin e aktivitetit.



Gjakata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan

Referuar arrestimeve në kuadër të operacionit të koduar **“Tempulli 2”**, datë **25.01.2024**, Gjakata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, informon sa më poshtë:

Më datë 25.01.2024, Gjakata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan me trup gjykues të përbërë nga gjyqtare **Znj. Idush Maliqi**, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore kërkesën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Paarë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan me objekt “Kërkesë për vleftësimin e ligjshëm të arrestimit/ndalimit dhe caktimin e masës së sigurimit”, ndaj shtetasve: G.M.; F.H.; B.H.; A.C.; Pas shqyrtimit në seancë gjyqësore Gjakata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, **me vendimin nr. 56 (61300-00275-13)**, datë **25.01.2024**, ka vendosur:

- 1- Vleftësimin të ligjshëm të ndalimit për personin nën hetim G.M. - Caktimin e masës së sigurimit “Arrest në burg” për personin nën hetim G.M., parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, - Urdhërohet mbajtja në paraburgim i personit nën hetim G.M..
- 2- Vleftësimin të ligjshëm të ndalimit për personin nën hetim F.H.. - Caktimin e masës së sigurimit “Arrest ne burg” për personin nën hetim F.H.. parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, - Urdhërohet mbajtja ne paraburgim i personit nën hetim F.H..
- 3.-Vleftësimin të ligjshëm të ndalimit për personin nën hetim B.H. -Caktimin e masës së sigurimit “Arrest në shtëpi” për personin nën hetim B.H., parashikuar nga neni 237 i K P Penale. -Urdhërohet personi nën hetim B.H., të mos largohet nga banesa e tij .. -Urdhërohet lirimi i menjëhershëm i personit nën hetim B.H. nga paraburgimi, nëse nuk mbahet për ndonjë shkak tjetër. -Prokurori dhe policia gjyqësore të mbikqyrin zbatimin e masës nga personi nën hetim
- 4.-Vleftësimin të ligjshëm të ndalimit për personin nën hetim A.C. - Caktimin e masës së sigurimit “Arrest ne burg” për personin nën hetim A.C., parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, - Urdhërohet mbajtja në paraburgim i personit nën hetim A.C. -Avokatja kryesisht të paguhet sipas tarifave shtetërore
- 5.-Kundër vendimit lejohet ankim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë brenda 5 ditëve duke filluar ky afat nga e nesermja e njoftimit të vendimit.

U shpall në Elbasan më 25.01.2024

Në funksion të transparencës dhe mirëinformimit mbi ceshtje të interesit të lartë publik, njoftimi për shpalljen e vendimit u publikua në faqen zyrtare të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, në adresën www.gjakata.gov.al, në rubrikën “Pasqyra e Shtypit”.



Gjykata e Shkallës së Parë
e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan

Përfundimi i shqyrtimit gjyqësor për çështjen e operacionit të Koduar Tempulli 2

Referuar arrestimeve në kuadër të operacionit të koduar **"Tempulli 2"**, datë **22.01.2024**, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, informon sa më poshtë:

Më datë 25.01.2024, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan me trup gjykues të përbërë nga gjyqtare **Znj. Thomaidha Roça**, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore kërkesën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan me objekt "Kërkesë për vleftësimin e ligjshëm të arrestimit/ndalimit dhe caktimin e masës së sigurimit", ndaj shtetasve: **D.(E)K., G.H.; A.K.; G.L.; K.A.; A.R.; S.K.; E.L.; D.B.; V.T.; D. Ç.; A.L.; B.K.; H.S.; G.D.; A.R.; XH.S.; D.P.; XH.P.;**

Pas shqyrtimit në seancë gjyqësore Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, **me vendimin nr. 58, datë 25.01.2024**, vendosi:

- 1.- Vleftësimin e ligjshëm të ndalimit në datën 22.01.2024, ora 13:15 të shtetasit D.E.K.; i dyshuar për kryerjen e veprës penale "Prodhimi dhe shitja enarkotikëve, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal. -Caktimin ndaj shtetasit D.E.K.; të masës së sigurimit personal "Arrest në burg", parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale. - Urdhërohet izolimni i shtetasit D.E.K.; në ambientet e paraburgimit pranë një Institucioni të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, për të qenë në dispozicion të organit të procedurës.
- 2.- Vleftësimin e ligjshëm të ndalimit në datën 22.01.2024, ora 14:15 të shtetasit G.H.; i dyshuar për kryerjen e veprës penale "Prodhimi dhe shitja enarkotikëve, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal. -Caktimin ndaj shtetasit G.H.; të masës së sigurimit personal "Arrest në burg", parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale. - Urdhërohet izolimni i shtetasit G.H.; në ambientet e paraburgimit pranë një Institucioni të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, për të qenë në dispozicion të organit të procedurës.
- 3.- Vleftësimin e ligjshëm të ndalimit në datën 22.01.2024, ora 13:00 të shtetasit A.K.; i dyshuar për kryerjen e veprës penale "Prodhimi dhe shitja enarkotikëve, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal. -Caktimin ndaj shtetasit A.K.; të masës së sigurimit personal "Arrest në burg", parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale. - Urdhërohet izolimni i shtetasit A.K.; në ambientet e paraburgimit pranë një Institucioni të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, për të qenë në dispozicion të organit të procedurës.
- 4.- Vleftësimin e ligjshëm të ndalimit në datën 22.01.2024, ora 13:25 të shtetasit G.L.; i dyshuar për kryerjen e veprës penale "Prodhimi dhe shitja enarkotikëve, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal. Caktimin ndaj shtetasit G.L.; të masës së sigurimit personal "Arrest në burg", parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale. - Urdhërohet izolimni i shtetasit G.L.; në ambientet e paraburgimit pranë një Institucioni të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, për të qenë në dispozicion të organit të procedurës.

5.-Vleftësimin e ligjshëm të ndalimit në datën 22.01.2024, ora 13:35 të shtetasit K.A.; i dyshuar për kryerjen e veprës penale "Prodhimi dhe shitja enarkotikëve, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal. -Caktimin ndaj shtetasit K.A.; të masës së sigurimit personal"Arrest në burg", parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale. - Urdhërohet izolimni i shtetasit K.A.; në ambientet e paraburgimit pranë një Institucioni të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, për të qenë në dispozicion të organit të procedurës.

6.-Vleftësimin e ligjshëm të ndalimit në datën 22.01.2024, ora 13:55 të shtetasit A.R.; i dyshuar për kryerjen e veprës penale "Prodhimi dhe shitja enarkotikëve, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal. -Caktimin ndaj shtetasit A.R.; të masës së sigurimit personal"Arrest në burg", parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale. - Urdhërohet izolimni i shtetasit A.R.; në ambientet e paraburgimit pranë një Institucioni të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, për të qenë në dispozicion të organit të procedurës.

7.-Vleftësimin e ligjshëm të ndalimit në datën 22.01.2024, ora 13:45 të shtetasit S.K.; i dyshuar për kryerjen e veprës penale "Prodhimi dhe shitja enarkotikëve, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal. -Caktimin ndaj shtetasit S.K.; të masës së sigurimit personal"Arrest në burg", parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale. - Urdhërohet izolimni i shtetasit S.K.; në ambientet e paraburgimit pranë një Institucioni të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, për të qenë në dispozicion të organit të procedurës.

8.-Vleftësimin e ligjshëm të ndalimit në datën 22.01.2024, ora 14:05 të shtetasit E.L.; i dyshuar për kryerjen e veprës penale "Prodhimi dhe shitja enarkotikëve, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal. -Caktimin ndaj shtetasit E.L.; të masës së sigurimit personal"Arrest në burg", parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale. - Urdhërohet izolimni i shtetasit E.L.; në ambientet e paraburgimit pranë një Institucioni të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, për të qenë në dispozicion të organit të procedurës.

9.-Vleftësimin e ligjshëm të ndalimit në datën 22.01.2024, ora 14:05 të shtetasit D.B.; i dyshuar për kryerjen e veprës penale "Prodhimi dhe shitja enarkotikëve, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal. -Caktimin ndaj shtetasit D.B.; të masës së sigurimit personal"Arrest në burg", parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale. - Urdhërohet izolimni i shtetasit D.B.; në ambientet e paraburgimit pranë një Institucioni të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, për të qenë në dispozicion të organit të procedurës.

10.-Vleftësimin e ligjshëm të ndalimit në datën 22.01.2024, ora 15:20 të shtetasit V.T.; i dyshuar për kryerjen e veprës penale "Prodhimi dhe shitja enarkotikëve, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal. -Caktimin ndaj shtetasit V.T.; të masës së sigurimit personal"Arrest në burg", parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale.- Urdhërohet izolimni i shtetasit V.T.; në ambientet e paraburgimit pranë një Institucioni të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, për të qenë në dispozicion të organit të procedurës.

11.-Vleftësimin e ligjshëm të ndalimit në datën 22.01.2024, ora 15:30 të shtetasit D. Ç.; i dyshuar për kryerjen e veprës penale "Prodhimi dhe shitja enarkotikëve, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal. -Caktimin ndaj shtetasit D. Ç.; të masës së sigurimit personal"Arrest në burg", parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale. - Urdhërohet izolimni i shtetasit D. Ç.; në ambientet e paraburgimit pranë një Institucioni të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, për të qenë në dispozicion të organit të procedurës.

12.-Ndalimi i datës 22.01.2024, ora 16:00 i shtetasit A.Ll.; i dyshuar për kryerjen e veprës penale "Moskallëzim i krimit", parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal, nuk vlerësohet i kryer në mënyrë të ligjshme. -Caktimin ndaj shtetasit nën hetim A.Ll.; të masës së sigurimit personal"Arrest në shtëpi", parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale.

13.-Vleftësimin e ligjshëm të ndalimit në datën 22.01.2024, ora 15:40 të shtetasit B.K.; i dyshuar për kryerjen e veprës penale "Prodhimi dhe shitja enarkotikëve," parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal. -Caktimin ndaj shtetasit B.K.; të masës së sigurimit personal"Arrest në burg", parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale. - Urdhërohet izolimni i shtetasit B.K.; në ambientet e paraburgimit pranë një Institucioni të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, për të qenë në dispozicion të organit të procedurës.

14.-Vleftësimin e ligjshëm të ndalimit në datën 22.01.2024, ora 15:50 të shtetasit H.S.; i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Prodhimi dhe shitja enarkotikëve,” parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal. -Caktimin ndaj shtetasit H.S.; të masës së sigurimit personal"Arrest në burg", parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale. - Urdhërohet izolimni i shtetasit H.S.; në ambientet e paraburgimit pranë një Institucioni të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, për të qenë në dispozicion të organit të procedurës.

15.-Vleftësimin e ligjshëm të arrestimit në flagrancë në datën 22.01.2024, ora 15:00 të shtetasit G.D.; i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Prodhimi dhe shitja enarkotikëve,” parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal. - Caktimin ndaj shtetasit G.D.; të masës së sigurimit personal"Arrest në burg", parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale. - Urdhërohet izolimni i shtetasit G.D.; në ambientet e paraburgimit pranë një Institucioni të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, për të qenë në dispozicion të organit të procedurës.

16.-Vleftësimin e ligjshëm të arrestimit në flagrancë në datën 22.01.2024, ora 16:00 të shtetasit A.R.; i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Prodhimi dhe shitja enarkotikëve,” parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal. - Caktimin ndaj shtetasit A.R.; të masës së sigurimit personal"Arrest në burg", parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale. - Urdhërohet izolimni i shtetasit A.R.; në ambientet e paraburgimit pranë një Institucioni të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, për të qenë në dispozicion të organit të procedurës.

17.-Vleftësimin e ligjshëm të arrestimit në flagrancë në datën 22.01.2024, ora 18:00 të shtetasit XH.S.; i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Prodhimi dhe shitja enarkotikëve,” parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal. - Caktimin ndaj shtetasit XH.S.; të masës së sigurimit personal"Arrest në burg", parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale. - Urdhërohet izolimni i shtetasit XH.S.; në ambientet e paraburgimit pranë një Institucioni të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, për të qenë në dispozicion të organit të procedurës.

18.-Vleftësimin e ligjshëm të arrestimit në flagrancë në datën 22.01.2024, ora 16:20 të shtetasit D.P.; i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Prodhimi dhe shitja enarkotikëve,” parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal. - Caktimin ndaj shtetasit D.P.; të masës së sigurimit personal"Arrest në burg", parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale. - Urdhërohet izolimni i shtetasit D.P.; në ambientet e paraburgimit pranë një Institucioni të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, për të qenë në dispozicion të organit të procedurës.

19.-Vleftësimin e ligjshëm të arrestimit në flagrancë në datën 22.01.2024, ora 16:00 të shtetasit XH.P.; i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Prodhimi dhe shitja enarkotikëve,” parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal. - Caktimin ndaj shtetasit XH.P.; të masës së sigurimit personal"Arrest në burg", parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale. - Urdhërohet izolimni i shtetasit XH.P.; në ambientet e paraburgimit pranë një Institucioni të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, për të qenë në dispozicion të organit të procedurës.

20.- Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Paarë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan në bashkëpunim me Policinë Gjyqësore, ngarkohen për ekzekutimin e këtij vendimi. 21.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, brenda (pesë) ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

U shpall në Elbasan, në datën 25.01. 2024.

Në funksion të transparencës dhe mirëinformimit mbi ceshtje të interesit të lartë publik, njoftimi për shpalljen e vendimit u publikua në faqen zyrtare të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, në adresën www.gjykata.gov.al, në rubrikën "Pasqyra e Shtypit".



Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan në kuadër të transparencës, me qëllim mirëinformimin e publikut në lidhje me ngjarjen e ndodhur në qytetin e Prrrenjasit, njofton se zhvilloi sot më datë më datë **17.04.2024**, seancën gjyqësore për masën e sigurimit që i përket kërkesës së paraqitur nga Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, ndaj personit nën hetim J. D., me objekt “Vleftësim ndalimi, caktim mase sigurimi”.

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, me vendimin **nr. 256 (61300-01208-13- 2024)**, vendim i cili nuk ka marrë formë të prerë, me trup gjykues **znj. Idush Maliqi** vendosi:

1. Vleftësim të ligjshëm të ndalimit për personin nën hetim J.D.;
2. Caktimin e masës së sigurimit “Arrest në burg” për personin nën hetim J. D., parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale;
3. Urdhërohet mbajtja në paraburgim e personit nën hetim J. D.;
4. Kundër vendimit lejohet ankim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë brenda 5 ditëve duke filluar ky afat nga e nesërmja e njoftimit të vendimit.

U shpall në Elbasan më 17.04.2024

Në funksion të transparencës dhe mirëinformimit mbi ceshtje të interesit të lartë publik, njoftimi për shpalljen e vendimit u publikua në faqen zyrtare të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, në adresën www.gjykata.gov.al, në rubrikën "Pasqyra e Shtypit".



Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan në kuadër të transparencës, me qëllim mirëinformimin e publikut në lidhje me ngjarjen e ndodhur në fshatin “Mengël” njofton se zhvilloi më datë **19.04.2024**, seancën gjyqësore për masën e sigurimit që i përket kërkesës së paraqitur nga Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, ndaj personave nën hetim **B.J.**, dhe **R.B.**, me objekt “Vleftësim ndalimi, caktim mase sigurimi”. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për shtetasin R.B., parashtroi kërkesën për masën e sigurisë “Arrest shtëpie”, ndërsa për shtetasin B.J., parashtroi kërkesën për masën e sigurisë “Arrest në Burg”.

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, me **vendimin nr. 263 (61300-01236-13- 2024)**, vendim i cili nuk ka marrë formë të prerë, pas shqyrtimit në seancë gjyqësore më datë **19.04.2024** me trup gjykues **znj. Idush Maliqi** vendosi:

1. Vleftësim të ligjshëm të ndalimit për personin nën hetim B.J.;
2. Caktimin e masës së sigurimit “Arrest ne burg” për personin nën hetim B. J., parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale;
3. Urdhërohet mbajtja në paraburgim i personit nën hetim B. J.;
4. Vleftësimin të ligjshëm të ndalimit për personin nën hetim R.B.;
5. Caktimin e masës së sigurimit “Arrest në shtëpi” për personin nën hetim R.B., parashikuar nga neni 237 i K P Penale;
6. Urdhërohet personi nën hetim R.B., të mos largohet nga banesa e tij;
7. Urdhërohet lirimi i menjëhershëm i personit nën hetim R. B. nga paraburgimi, nëse nuk mbahet për ndonjë shkak tjetër;
8. Prokurori dhe policia gjyqësore të mbikqyrin zbatimin e masës nga personi nën hetim R.B.;
9. Kundër vendimit lejohet ankim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë brenda 5 ditëve duke filluar ky afat nga e nesërmja e njoftimit të vendimit;

U shpall në Elbasan më 19.04.2024

Në funksion të transparencës dhe mirëinformimit mbi ceshtje të interesit të lartë publik, njoftimi për shpalljen e vendimit u publikua në faqen zyrtare të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, në adresën www.gjykata.gov.al, në rubrikën "Pasqyra e Shtypit"



Puna me interes publik është masë dënimi e cila është parashikuar në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë në Nenin 63 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, i cili përcakton: ***“Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik. Gjykata, për shkak të rrezikshmërisë së pakët të personit dhe të rrethanave të kryerjes së veprës penale, kur ka caktuar një dënim gjer në një vit burgim, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe zëvendësimin e tij me detyrimin që i dënuari të përmbushë një punë në interes publik. Puna me interes publik nënkupton kryerjen nga i dënuari të një pune, me pëlqimin e tij dhe pa shpërblim, në favor të interesit publik apo shoqatës së caktuar në vendimin e gjykatës, për një kohë nga dyzet deri në dyqind e dyzet orë. Ky detyrim nuk mund të vendoset kur i dënuari refuzon pezullimin në seancë gjyqësore. Puna në interes publik kryhet brenda afatit prej gjashtë muajsh. Në vendimin e saj gjykata përcakton numrin e orëve të punës dhe detyrimin që i dënuari të mbajë kontakte me shërbimin e provës. Shërbimi i provës vendos llojin e punës që do të kryhet, përcakton vendin e kryerjes së punës dhe ditët e javës kur do të kryhet ajo, duke pasur parasysh, për aq sa është e mundur, punësimin e rregullt të të dënuarit apo detyrimet e tij familjare. Kohëzgjatja e punës me interes publik nuk i kalon tetë orë në ditë. Pas përfundimit të punës, dënimi konsiderohet i paqenë. Nëse i dënuari nuk kryen punën me interes publik, nuk mban kontakte me shërbimin e provës apo shkel kushtet ose detyrimet e tjera, të vendosura nga gjykata, prokurori informon menjëherë gjykatën. Gjykata, në këtë rast, vendos sipas nenit 62 të këtij Kodi.”***

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan disponon një regjistër të cilin e bën publik në faqen e saj zyrtare, në të cilin raportohet mbi aplikimin e masës së dënimit sipas dispozitës ligjore të parashikuar në nenin 63 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, për të cilin raportohet për kategorinë e subjekteve të dënuar dhe për kategorinë e subjekteve të mitur në konflikt me ligjin, në përputhje me parashikimin e Nenit 1 të Kodi Penal të Republikës së Shqipërisë, i cili përcakton “Ligji penal dhe ndarja e veprave penale në të cilën përcaktohet se Ligji penal përcakton veprat penale, dënimet dhe masat e tjera që merren ndaj autorëve të tyre.”

Kategorizimi i tyre bëhet “Neni1/2. Veprat penale ndahen në krime dhe në kundërvajtje penale. Dallimi i tyre bëhet në çdo rast në dispozitat e pjesës së posaçme të këtij Kodi.”



Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan

Nga të dhënat e publikuara të statistikave rezulton se raportimi i të dhënave është kryer sipas kategorizimit të aplikimit të masës së dënimit të parashikuar nga neni 63 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, të ndara këto në Vepra Penale dhe Kundërvajtje.

ju përcjellim në vijim një pasqyrë narrative për veprat penale dhe kundërvajtjet për të cilat është aplikuar si masë dënimi neni 63 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë për vitet 2020-2024, për të dënuar dhe të mitur në konflikt me ligjin si në vijimi:

Në të dhënat e statistikave të Vitit 2020 rezulton;

Totali i të dënuarve për të cilët është aplikuar masa e dënimit të parashikuar nga neni 63 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë rezulton të jetë 52 (pesëdhjetë e dy), nga të cilat:

- 44 (dyzet e katër) të dënuar për Vepra Penale;
- 8(tetë) të dënuar për Kundërvajtje.

Veprat Penale për të cilat është aplikuar Neni 63 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë janë si në vijim:

Neni 130/a - Dhuna në familje, janë dhënë 3(tre) masa dënimi në të cilën është aplikuar neni 63 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 134- Vjedhja, janë dhënë 2(dy) masa dënimi në të cilën është aplikuar neni 63 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 190- Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve, është dhënë 1 (një) masë dënimi në të cilën është aplikuar neni 63 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 199/a - Ndërtimi i paligjshëm, janë dhënë 13 (trembëdhjetë) masa dënimi në të cilën është aplikuar neni 63 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 236/2- Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik. 2. Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose duke ushtruar dhunë fizike ose më shumë, është dhënë 1 (një) masë dënimi në të cilën është aplikuar neni 63 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 237- Goditjet për shkak të detyrës, janë dhënë 2(dy) masa dënimi në të cilën është aplikuar neni 63 i i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 291- Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt, janë dhënë 20 (njëzet) masa dënimi në të cilën është aplikuar neni 63 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 301- Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës, është dhënë 1 (një) masë dënimi në të cilën është aplikuar neni 63 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.



Gjykata e Shkallës së Parë
e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan

Neni 309- Ekspertimi i rremë, është dhënë 1 (një) masë dënimi në të cilën është aplikuar neni 63 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Kundërvajtje për të cilat është aplikuar neni 63 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë janë dhënë për nenet si në vijim:

Neni 137/1- Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike, janë dhënë 2(dy) masa dënimi në të cilën është aplikuar neni 63 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 205- Prerja e paligjshme e pyjeve, është dhënë 1 (një) masë dënimi në të cilën është aplikuar neni 63 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 242- Mosbindja ndaj urdhrit të punonjësit të policisë së rendit publik, janë dhënë 2(dy) masa dënimi në të cilën është aplikuar neni 63 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 247/1- Mbajtja pa të drejtë e uniformës, është dhënë 1 (një) masë dënimi në të cilën është aplikuar neni 63 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 274- Prishja e qetësisë publike, është dhënë 1 (një) masë dënimi në të cilën është aplikuar neni 63 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 278/2- Mbajtja e municioneve luftarake...2. pa lejen e organeve kompetente shtetërore, është dhënë 1 (një) masë dënimi në të cilën është aplikuar neni 63 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Për të mitur në konflikt me ligjin nga të dhënat statistikave për vitin 2020, nuk rezulton të ketë pasur aplikim të masës së dënimit të parashikuar nga neni 63 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, as për Vepra Penale, as për Kundërvajtje.

Në të dhënat e statistikave të Vitit 2021 rezulton;

Totali i të dënuarve për të cilët është aplikuar masa e dënimit e parashikuar nga neni 63 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë rezulton të jetë 76 (shtatëdhjetë e gjashtë), nga të cilat:

-61 (gjashtëdhjetë e një) të dënuar për Vepra Penale;

-15 (pesëmbëdhjetë) të dënuar për Kundërvajtje.

Veprat Penale për të cilat është aplikuar Neni 63 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë janë si në vijim:

Neni 121/a- Përndjekja, janë dhënë 3 (tre) masa dënimi në të cilën është aplikuar neni 63 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.



Gjykata e Shkallës së Parë
e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan

Neni 130/a- Dhuna në familje, janë dhënë 4 (katër) masa dënimi në të cilën është aplikuar neni 63 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 134- Vjedhja, është dhënë 1 (një) masë dënimi në të cilën është aplikuar neni 63 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 178- Tregtimi dhe transportimi i mallrave që janë kontrabandë, janë dhënë 2 (dy) masa dënimi në të cilën është aplikuar neni 63 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 180- Fshehja e të ardhurave është dhënë 1 (një) masë dënimi në të cilën është aplikuar neni 63 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 186- Falsifikimi i dokumenteve, është dhënë 1 (një) masë dënimi në të cilën është aplikuar neni 63 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 190- Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve, janë dhënë 2 (dy) masa dënimi në të cilën është aplikuar neni 63 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

199/a- Ndërtimi i paligjshëm, janë dhënë 7 (shtatë) masa dënimi në të cilën është aplikuar neni 63 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 236/2- Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik 2. Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose duke ushtruar dhunë fizike ose më shumë, është dhënë 1 (një) masë dënimi në të cilën është aplikuar neni 63 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 237- Goditjet për shkak të detyrës, është dhënë 1 (një) masë dënimi në të cilën është aplikuar neni 63 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 278- Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit, është dhënë 1 (një) masë dënimi në të cilën është aplikuar neni 63 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 279- Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta, është dhënë 1 (një) masë dënimi në të cilën është aplikuar neni 63 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 283- Prodhimi dhe shitja e narkotikëve, janë dhënë 5 (pesë) masa dënimi në të cilën është aplikuar neni 63 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 290/2.3.4- Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor 2. kur ka shkaktuar plagosjen e rëndë 3. kur ka shkaktuar vdekjen e një personi 4. është shkaktuar vdekja ose plagosja e rëndë e disa personave, është dhënë 1 (një) masë dënimi në të cilën është aplikuar neni 63 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 291- Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt, janë dhënë 28 (njëzet e tetë) masa dënimi në të cilën është aplikuar neni 63 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 298- Ndhurma për kalim të paligjshëm të kufijve, është dhënë 1 (një) masë dënimi në të cilën është aplikuar neni 63 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 305- Kallëzimi i rremë, është dhënë 1 (një) masë dënimi në të cilën është aplikuar neni 63 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.



Gjykata e Shkallës së Parë
e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan

Kundërvajtje për të cilat është aplikuar neni 63 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë janë dhënë për nenet si në vijim:

Neni 110/1- Trafikimi i personave të rritur, është dhënë 1 (një) masë dënimi në të cilën është aplikuar neni 63 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 130/a.1- Dhuna në familje. 1. Rrahja, si dhe çdo vepër tjetër dhune, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit fizik, psiko-social dhe ekonomik të tij, janë dhënë 2(dy) masa dënimi në të cilën është aplikuar neni 63 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë

Neni 137/1- Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike, është dhënë 1 (një) masë dënimi në të cilën është aplikuar neni 63 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 197- Organizimi i llotarive të palejuara, janë dhënë 4 (katër) masa dënimi në të cilën është aplikuar neni 63 i I Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 242- Mosbindja ndaj urdhrat të punonjësit të policisë së rendit publik, janë dhënë 2(dy) masa dënimi në të cilën është aplikuar neni 63 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 277- Vetëgjyqësia, janë dhënë 2(dy) masa dënimi në të cilën është aplikuar neni 63 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 280- Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive, është dhënë 1 (një) masë dënimi në të cilën është aplikuar neni 63 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 288/a.1- Prodhimi i kundërligjshëm i artikujve dhe mallrave industrialë dhe ushqimorë, është dhënë 1 (një) masë dënimi në të cilën është aplikuar neni 63 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 320- Pengime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës, është dhënë 1 (një) masë dënimi në të cilën është aplikuar neni 63 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Për të dënuar të mitur për vitin 2021 janë dhënë 2(dy) masa dënimi për veprën penale të parashikuar nga **Neni 291-** Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt, në të cilën është aplikuar neni 63 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, nuk rezultojnë masa dënimi për të cilat është aplikuar neni 63 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë për Kundërvajtje.

Në të dhënat e statisitkave të Vitit 2022 rezultojnë;

Totali i të dënuarve për të cilët është aplikuar masa e dënimit e prarashikuar nga neni 63 I Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, rezultojnë të jetë 34 (tridhjetë e katër) nga të cilat janë aplikuar për:

-31 (tridhjetë e një) të dënuar për Vepra Penale

-3 (tre) të dënuar për Kundërvajtje;



Gjykata e Shkallës së Parë
e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan

Veprat Penale për të cilat është aplikuar Neni 63 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë janë si në vijim:

Neni 117/2.3- Pornografia 2.Prodhimi, importimi, ofrimi, vënia në dispozicion, shpërndarja, transmetimi, përdorimi ose posedimi i pornografisë së fëmijëve, si dhe krijimi i aksesit në mënyrë të vetëdijshme në të, me çdo mjet ose formë,3. Rekrutimi, përdorimi, shtrëngimi, ose bindja e një fëmije, për të marrë pjesë në shfaqje pornografike, ose marrja pjesë në shfaqje pornografike që përfshijnë fëmijët, është dhënë 1 (një) masë dënimi në të cilën është aplikuar neni 63 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 130/a.2.3.4- Dhuna në familje...2. Kanosja serioze për vrasje ose plagosje të rëndë 3. Plagosja e kryer me dashje....4. vepra të kryera në mënyrë të përsëritur, është dhënë 1 (një) masë dënimi në të cilën është aplikuar neni 63 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 137- Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike, është dhënë 1 (një) masë dënimi në të cilën është aplikuar neni 63 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 180- Fshehja e të ardhurave, është dhënë 1 (një) masë dënimi në të cilën është aplikuar neni 63 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 199/a.2.3- Ndërtimi i paligjshëm 2. Po kjo vepër, e kryer në tokën publike ose shtetërore apo në tokën e tjetrit 3 Po kjo vepër, kur ka sjellë pasoja të rënda apo e kryer për qëllime fitimi, janë dhënë 3 (tre) masa dënimi në të cilën është aplikuar neni 63 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 248- Shpërdorimi i detyrës, është dhënë 1 (një) masë dënimi në të cilën është aplikuar neni 63 i i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 279- Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta, është dhënë 1 (një) masë dënimi në të cilën është aplikuar neni 63 i i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 291- Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt, janë dhënë 21 (njëzet e një) masa dënimi në të cilën është aplikuar neni 63 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 298- Ndhurma për kalim të paligjshëm të kufijve, është dhënë 1 (një) masë dënimi në të cilën është aplikuar neni 63 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Kundërvajtje për të cilat është aplikuar neni 63 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë janë dhënë për nenet si në vijim:

Neni 273- Largimi nga vendi i aksidentit, është dhënë 1 (një) masë dënimi në të cilën është aplikuar neni 63 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 297- Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror, është dhënë 1 (një) masë dënimi në të cilën është aplikuar neni 63 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 320- Pengime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës, është dhënë 1 (një) masë dënimi në të cilën është aplikuar neni 63 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.



Gjykata e Shkallës së Parë
e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan

Për të dënuar të mitur për vitin 2022 është dhënë 1(një) masë dënimi për veprën penale të parashikuar nga **Neni 117/2.3**- Pornografia...2.shpërndarja,...3reklamimi,...në të cilën është aplikuar neni 63 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë. Nuk rezultojnë masa dënimi për vepra penale të kategorizuara Kundërvajtje në të cilën është aplikuar neni 63 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Në të dhënat e statisitkave të Vitit 2023 rezulton;

Totali i të dënuarve për të cilët është aplikuar masa e dënimit të prarashikuar nga neni 63 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë rezulton të jetë 3(tre) nga të cilat:

- 3(tre) të dënuar për Vepra Penale;
- 0 (zero) të dënuar për Kundërvajtje;

Veprat Penale për të cilat është aplikuar Neni63 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë janë si në vijim:

Neni 130/a.2.3.4- Dhuna në familje...2. Kanosja serioze për vrasje ose plagosje të rëndë 3. Plagosja e kryer me dashje....4. vepra të kryera në mënyrë të përsëritur, janë dhënë 3 (tre) masa dënimi në të cilën është aplikuar neni 63 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Nuk rezulton të jenë dhënë për të cilat është aplikuar neni 63 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë për Kundërvajtje.

Për të dënuar të mitur për vitin 2023, nuk rezultojnë masa dënimi për të cilat është aplikuar neni 63 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë për Kundërvajtje për Vepra Penale dhe Kundërvajtje.

Në të dhënat e statisitkave të Vitit 2024 rezulton;

Totali i të dënuarve për të cilët është aplikuar masa e dënimit të prarashikuar nga neni 63 ti Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë rezulton të jetë 0 (zero) të dënuar nga të:

- 0 (zero) të dënuar për Vepra Penale
- 0 (zero) të dënuar për Kundërvajtje;

Për të dënuar të mitur për vitin 2024 rezulton, 1 (një) aplikim i masës së dënimit të përcaktuar në neni 63 të i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë të Republikës së Shqipërisë për veprën penale të parashikuar nga Neni 291. i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë- Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt dhe 1 (një) aplikim i masës së dënimit të përcaktuar në neni 63 të i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë të Republikës së Shqipërisë për Kundërvajtje e parashikuar nga Neni 89- i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë. Plagosja e lehtë me dashje. Në total 2 (dy).



Gjykata e Shkallës së Parë
e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan

ASISTENCA E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR

Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan është rritur angazhimi dhe asistenca për personat me aftësi të kufizuar, gjykata ka përcaktuar një ambient të posaçëm për qëndrimin, publikimin e të drejtave dhe garancive të personave me aftësi të kufizuar.

Gjykata ka siguruar akses fizik nëpërmjet rampave të personave me aftësi të kufizuar në lëvizje, në sallat e gjyqit. Për vitin 2022-2024, ky akses fizik garantohet për të 10-të sallat e gjykimit dhe hyrjet në gjykatë. Gjithashtu gjykata ka pajisur mjediset e aksesit publik.

Kryesekretaria dhe sallat e gjykimit janë të pajisura me tregues për personat me shikim të kufizuar. Sfidë për të ardhmen mbetet siguri i asistencës së specializuar për interprete etj., nga organizata joqeveritare për personat me aftësi të kufizuar që marrin pjesë në procese apo marrin shërbim në gjykatë.

Është bërë e mundur funksionimi i video-konferencës për zhvillimin e seancave pa praninë fizike të personave, duke përfshirë edhe personat me aftësi të kufizuar si dhe konsultimin online të dosjeve gjyqësore. Institucioni gjithashtu është i pajisur me ashensor.

Në periudhën 2022-2024 në kërkesat e paraqitura nëpërmjet e-mail të postës elektronike të gjykatës, nuk rezultojnë kërkesa për vënie në dispozicion të vendimit të gjykatës në format Brail, gjithashtu nuk rezultojnë kërkesa të depozituara në protokoll me këtë objekt.

Nga të dhënat e Zyrës së Buxhetit nuk rezultojnë të dhëna shpenzimesh të kryera, për kërkesa të palëve për nevoja të interpretit të gjuhës së shenjave apo sistemit të shkrimit Braille.

Nevoja për interpret të gjuhës së shenjave është edhe e vetë gjykatës, për interpretim të videove që duhet të vendosim në dispozicion të informimit të publikut edhe për kategorinë e personave me aftësi të kufizuar, në kuadër të plotësimit të objektivave të Planit Strategjik të Komunikimit, miratuar me vendimin nr. 590 datë 26.11.2020 nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Gjatë vitit 2023 dhe 2024, në kuadër të sensibilizimit të të rinjve në lidhje me aftësinë e kufizuar dhe të drejtat e fëmijëve, janë organizuar takime dhe janë angazhuar një numër i konsiderueshëm nxënësish, në bashkëpunim edhe me institucionet arsimore, duke i ofruar informacion mbi legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar në lidhje me të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuar.



Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan

Në vitin 2024 temë specifike për trajtim dhe sensibilizim u përcaktua tematika *“Inkluzioni dhe informimi mbi të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuar”*, duke përshtatur informacionin mbi Deklaratën Salamanca 1994 dhe ligje kombëtare dhe ndërkombëtare me këtë objekt. Këtë informacion u angazhuam që të riprodhohej nga nxënësit në formën e një eseje në lidhje me këtë tematikë, esetë e të cilëve janë bërë publike në rrejtet sociale dhe në faqen zyrtare të gjykatës.

Nuk rezulton të jenë kryer trajnime të stafit të administratës për çështje të aftësisë së kufizuar për vitet 2022-2024.

Në gjykatë ka akses çdo palë në proces për pajisjen me kopje të regjistrimit audio të seancës pa përcaktime e kriteret e veçanta për marrjen e saj. Për marrjen e kopjes të CD-së, mjafton të depozitohet një kërkesë me objekt *“Pajisje me kopje të regjistrimit audio”* dhe pagesa e shpenzimeve gjyqësore.

Identifikimi i palëve në proces gjyqësor, mënyra e përfaqësimit të palëve gjendet në aktet e dosjeve gjyqësore sipas objekteve të kërkesë padive të depozituara, për të cilat gjykata në fund të procesit shprehet me vendimmarrje, e cila sërish bëhet pjesë e fashikullit të dosjes gjyqësore, por nuk rezultojnë statistika të detajuara me këtë objekt.

Në lidhje me shoqërimin e personave me aftësi të kufizuar, vihet re që kryesisht shoqërohen nga të afërmit dhe kujdestarët ligjorë. Informacionet që ofrohen në faqen zyrtare online të gjykatës janë kryesisht të orientuara në formë broshurash për dhënien e informacionit mbi legjislacionin për personat me aftësi të kufizuar. Për orientimin në gjykatë është realizuar video me zë por pa interpret të gjuhës së shenjave.

Në faqen zyrtare në rubrikën Njoftime për Publikun dhe rrjetet sociale në datë 20.04.2023 është publikuar në format broshure informacion me titull *“Fletëpalosje informuese për personat me aftësi të kufizuar”*, gjithashtu edhe në datë 04.08.2023 është publikuar informacion në format broshure me titull *“Personat me aftësi të kufizuar kuadri ligjor i garantimit të të drejtave të tyre në Shqipëri”*.

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan ka një zë në buxhet për të paguar përkthyesit e gjuhës së huaj, si edhe interpretët e gjuhës së shenjave. Buxheti i përdorur për vitet 2022-2023 është 0 all. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan nuk ka patur proces penal me të pandehur persona me aftësi të kufizuar në dëgjim dhe në të folur.

Përzgjedhja e interpretëve të gjuhës së shenjave bëhet nga lista e ekspertëve të licencuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë. Gjykatat janë përgjegjëse për të paguar interpretët e gjuhës së shenjave vetëm për çështjet që janë në gjykim, për të cilat shprehen trupat gjyqësore me vërtetim gjyqësor.



Gjykata e Shkallës së Parë
e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan

Për vitet 2022-2023 nuk ka patur refuzim nga interpretët e gjuhës së shenjave për të marrë pjesë në një proces penal.

Sipas të dhënave të gjeneruara nga Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore, rezulton se për çështjet me objekt “Heqje/ kufizim i zotësisë për të vepruar dhe caktim kujdestarie” janë regjistruar:

Në vitin 2022, janë regjistruar 4 (katër) kërkesa të reja me këtë objekt, ndër të cilat 2 janë në përpunim.

Në vitin 2022, në regjistrin manual rezulton të jenë caktuar 9 (nëntë) kujdestarë me vendimmarrje.

Në vitin 2023, janë regjistruar 2 (dy) kërkesa me këtë objekt, (1) një kërkesë rezulton me vendimmarrje dhe 1 (një) kërkesë rezulton në përpunim.

Në vitin 2023, në regjistrin manual rezulton 1 (një) vendimmarrje me caktimi kujdestarie.

Në vitin 2022, është regjistruar 1 (një) kërkesë civile e veçantë me bazë ligjore Ligj nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”, me objekt kërkesë “Revokim vendimi për velerësim të masës për shtrim dhe trajtim të pavullnetshëm të personave me çrregullime të shëndetit mendor” e cila është pranuar.

Në vitin 2022, është regjistruar 1 (një) kërkesë civile e veçantë me bazë ligjore Ligj nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”, me objekt kërkesë “Revokim vendimi për velerësim të masës për shtrim dhe trajtim të pavullnetshëm të personave me çrregullime të shëndetit mendor” e cila është pranuar.

Në vitin 2023, nuk rezultojnë regjistrime për kërkesat civile të veçanta me bazë ligjore Ligj nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”, me objekt kërkesë “Shtrim dhe trajtim të pavullnetshëm të personave me çrregullime të shëndetit mendor”.

Në vitin 2023, nuk rezultojnë regjistrime për kërkesat civile të vecanta me bazë ligjore Ligj nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”, me objekt kërkesë “Revokim vendimi për velerësim të masës për shtrim dhe trajtim të pavullnetshëm të personave me çrregullime të shëndetit mendor”.

Referuar Kodit Penal Neni 46 “Masat mjekësore dhe edukuese”. Masat mjekësore mund të jepen nga gjykata ndaj personave të papërgjegjshëm që kanë kryer vepër penale, ndërsa masat edukuese mund të jepen ndaj të miturve që përjashtohen nga dënimi ose që për shkak të moshës nuk kanë përgjegjësi penale. Masat mjekësore janë:



Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan


Vendimi gjyqësor për masat mjekësore dhe edukuese është i revokueshëm në çdo kohë kur zhduken rrethanat për të cilat ai është dhënë, por në çdo rast, gjykata, kryesisht, është e detyruar që pas kalimit të një viti nga dita e dhënies së vendimit, të marrë në shqyrtim vendimin e saj.

Rregullat për revokimin e vendimit gjyqësor që përmbajnë masa mjekësore parashikohen në Kodin e Procedurës Penale. Rregullat për caktimin ose revokimin e masave mjekësore dhe edukuese për të miturin parashikohen nga Kodi i Drejtësisë për të Mitur”.

Në vitin 2022, janë regjistruar 10 (dhjetë) kërkesa për pushim çështje dhe caktim mase mjekësore, ndër të cilat 9 (nëntë) kanë vendimmarrje dhe 1 (një) është në përpunim. Ndër to kemi 1 (një) vendimmarrje me kthim aktesh dhe 1 (një) vendimmarrje pushim, 7 (shtatë) vendimmarrje janë pranim i kërkesës për caktim mase mjekësore.

Për vitin 2023, janë regjistruar 2 (dy) kërkesa për pushim çështje dhe caktim mase mjekësore, ndër të cilat 1 (një) rezulton me vendimmarrje pranim kërkesë për pushim dhe caktim mase mjekësore dhe 1 (një) çështje rezulton ende në përpunim.

NDËRVEPRIMI ME MEDIAT



NDËRVEPRIMI ME MEDIAT

Nisur nga rëndësia që kanë: media, OSHC-të apo grupet e tjera të interesit në përcjelljen e informacionit dhe komunikimin me publikun, meqenëse, gjeneza e medias ka lindur pikërisht si kërkesë e publikut për të mësuar mbi dhe për pushtetin, si e tillë është jo vetëm një strukturë informuese për dhe mbi pushtetin, por edhe një strukturë plotësuese e kërkesave të publikut për të kontrolluar pushtetin, për ta ruajtur dhe strukturuar këtë formë të një rëndësie të veçantë për pasqyrim, Gjyqtari i Medias në koordinim me Trupën Gjyqësore të Gjykatës dhe Koordinatorin për të Drejtën e Informimit, ka mundësuar pjesëmarrje të vazhdueshme të medias për seanca gjyqësore për të cilat kanë shprehur interes dhe kanë patur interes të lartë publik, me synimin për të përcjellë mirëinformim dhe transparencë të proceseve gjyqësore dhe vendimmarrjeve, si edhe janë dhënë disa intervista në televizione kombëtare me kërkesë të medias.



Gjyqtari z. Ardit Kuka për Vizion Plus

Intervista e Gjyqtarit z. Ardit Kuka për Vizion Plus dhe Abc News më datë 31.01.2024 për kërkesat me objekt nenin 130/a "Dhuna në familje" dhe Ligj Nr.9669, neni 10 dhe 13, "Urdhëra mbrojtje".



Gjyqtari z. Artur Prenga për Top Media

Intervista e Gjyqtarit z. Artur Prenga për Top Channel më datë 11.06.2024 në lidhje me objekt "Statistika për të Dënuar të Mitur Vitet 2022-2023".



Gjyqtari z. Elis Dine për BIRN

Intervista e Gjyqtarit z. Elis Dine më datë 15.11.2024 për BIRN dhe ElbasaniOn me objekt "Veprat penale që lidhen me krimin kibernetik, dhunën në familje".



Gjyqtare znj. Suela Lika për RTSH

Intervista e Gjyqtares znj. Suela Lika, për RTSH me objekt "Statistika për llojet e veprave penale, veprat penale që lidhen me shitjen dhe prodhimin e lëndëve narkotike. Etj.."

Gjyqtari z. Ardit Kuka për Inside Story

Me ftesë të Inside Story, prononcimi i Gjyqtarit të Medias në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan z. Ardit Kuka, në Dokumentarin Investigativ për "Bandat Kriminale të Vitit 1997-të në qytetin e Elbasanit".

Zv/Kryetar z. Artur Prenga për Inside Story

Me ftesë të Inside Story, prononcimi i Zv/Kryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan z. Artur Prenga, në Dokumentarin Investigativ për "Të penduarit e drejtësisë".




NDËRVEPRIMI ME PUBLIKUN DHE PALËT E INTERESIT

Në kuadër të zbatimit të Planit Strategjik të Komunikimit për Sistemin Gjyqësor, miratuar me vendimin nr. 590 datë 26.11.2020, i cili synon përcaktimin e bazave për përmirësimin e marrëdhënieve të gjyqësorit me median dhe publikun, të kuptuarit prej publikut të mjeteve dhe mënyrës së komunikimit me gjykatat, të veprimtarisë dhe shërbimeve që ofrohen nga gjykatat, në zbatim të Ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në zbatim të nenit 91 të tij, i cili parashikon qasjen në drejtësi dhe marrëdhëniet me publikun dhe zbatim të Ligj nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i cili ngarkon gjykatat me detyrime specifike për të ndërtuar dhe garantuar transparencë mbi veprimtarinë e tyre për palët në proces, grupet e interesit, publikun dhe median si dhe me qëllim rritjen e transparencës së punës së Gjykatave, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan nisi zbatimin e tij në Vitin 2023 dhe gjatë kësaj periudhe kalendarike në zbatim të objektivave të përcaktuara në këtë plan, synuam të arrinim përmirësimin e nivelit të besimit të medias dhe të gjithë aktorëve të jashtëm ndaj gjykatës, nëpërmjet krijimit të lehtësisë të procedurave për aksesimin dhe marrjen e informacionit në mënyrë efikase, në kohë të shpejtë dhe në çdo rast brenda afateve ligjore duke përdorur mekanizma, mjete dhe mënyra inovatore të komunikimit dhe informimit midis Gjykatës drejt medias, publikut, institucionet dhe palët ndërgjyqëse.

Si kërkesë e ligjit për të Drejtën e Informimit dhe në zbatim të legjislacionit në fuqi, si edhe si pjesë e objektivave të Planit Strategjik të Komunikimit, jemi treguar rigoroz në trajtimin e kërkesë/ankesave të publikut që vijnë në adresë të postës elektronike dhe jo vetëm, nga palët në proces gjyqësor, publiku dhe mediat, duke zbatuar në mënyrë rigoroz legjislacionin në fuqi për të vlerësuar interesin e ligjshëm të palëve për marrjen e informacionit dhe për të mundësuar komunikimin e informacionit brenda afateve ligjore.

Është krijuar tradita e ndërveprimit me korrespondencë elektronike të përditëshme nga media, publiku, palët ndërgjyqëse, avokatët, institucione etj., të cilat ndërveprojnë nëpërmjet këtij mjeti për depozitimin e shpejtë të kërkesave për shtyrje të seancave gjyqësore, për depozitim aktesh për seancat gjyqësore, për kërkesa përshpejtim, kërkesa për informacion mbi çështjet në shqyrtim nga palët, informacione mbi statusin e gjykimit si edhe kërkesa të karakterit për informacione me karakter publik, kërkesat e medias mbi raporte e statistika për gjykimet.

Është krijuar tradita e informimit nëpërmjet njoftimeve publike për mungesën e gjyqtarëve në ditë të caktuara, në mënyrë që të evitohet pritja dhe të informohen palët ndërgjyqëse për moszhvillimin e seancave gjyqësore, për një komunikim sa më transparent.



NDËRVEPRIMI ME PUBLIKUN DHE PALËT E INTERESIT

Me qëllim promovimin dhe transparencën e informimit të publikikut kryhet vazhdimisht përditësimi i faqes zyrtare të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan nga Koordinatori për të Drejtën e Informimit, në lidhje me publikimin e listave të çështjeve të gjykit, shpalljeve publike, lajmërimeve përmes afishimit, njoftimeve për shtyp, publikimin e materialeve me informacion juridik mbi të drejtat e njeriut etj, duke ndihmuar kështu grupet e interesit për të patur një akses më të lehtë dhe më të thjeshtë në marrjen e informacionit për të cilin kanë interes. Në kuadër të transparencës për vitin 2023-2024, regjistri i kërkesave është plotësuar dhe publikuar në përputhje me formatin e përcaktuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit, Në këtë regjistër nuk publikohen kërkesat e depozituara në postën elektronike zyrtare të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan që lidhen me kërkesat për informacion të palëve mbi çështjet në gjykim të cilat rezultojnë në përpunim si psh (kërkesa për shortin, për planifikime seancash, kërkesa shtyrje, parashtrime, kërkesa drejtuar gjyqtarëve për çështjet në gjykim dhe përpunim etj) si edhe kërkesa të depozituar në Arkivën e Gjykatës për (dosje, akte dosjesh, vendime etj).

Totali i kërkesave të trajtuara për Vitin 2023 nëpërmjet postës elektronike zyrtare të Gjykatës është 575 (pesëqind e shtatëdhjetë e pesë) kërkesa. Ndër to, janë publikuar 35 (tridhjetë e pesë) kërkesa me karakter publik të cilat janë afishuar në regjistrin e kërkesave të publikuara sipas formatit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale.

Totali i kërkesave të trajtuara për Vitin 2024 të paraqitura nëpërmjet postës elektronike zyrtare të Gjykatës është 948 (nëntëqind e dyzet e tetë) kërkesa. Ndër to janë publikuar 79 (shtatëdhjetë e nënetë) kërkesa me karakter publik, të cilat janë afishuar në regjistrin e kërkesave të publikuara sipas formatit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale.

Në këtë të dhënë është përjashtuar korrespondecë e mbajtur me institucionet, Ambasadat etj., dhe janë përfshirë në këtë të dhënë (kërkesa nga palët ndërgjyqëse, përfaqësuesit ligjorë, mediat, publiku për: informacion mbi shortin; informacion për planifikime seancash gjyqësore, informacion me karakter publik, kërkesa të palëve ndërgjyqëse për shtyrje seancash gjyqësore, depozitime parashtrimesh, kërkesa drejtuar gjyqtarëve për çështjet në përpunim, kërkesa për pushim çështjes gjyqësore, kërkesa për statusin e gjykit, kërkesa për vendime gjyqësore, ankesa të palëve ndërgjyqëse, kërkesa për mospjesëmarrje në seancë gjyqësore, kërkesa për përsheptim etj).

Korrespondenca elektronike, rezulton se është një nga metodat inovatore nëpërmjet të cilës jo vetëm shtetasit, por edhe institucionet ndërveprojnë me efikasitet dhe me shpejtësi për të krijuar mundësi dhe akses të shpejtë në komunikim.



Më datë **01.10.2024**, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan zhvilloi Mbledhjen e Përgjithshme të Gjyqtarëve me rend dite Zgjedhja e Zv/Kryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Në përfundim të procedurës së votimit, Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve zgjodhi Zv/Kryetarin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan **z. Artur Prenga**.

Z. ARTUR PRENGA


Zv/Kryetar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan

Z. Artur Prenga u lind më 25.04.1989. Në vitin 2012 kreu studimet në Universitetin “Luigj Gurakuqi”, Fakulteti i Drejtësisë. Në vitin 2014 kreu studimet pasuniversitare në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, Departamenti i të Drejtës Penale, Master i Shkencave në Drejtë Penale. Në vitin 2016 kreu studimet në Shkollën Kombëtare të Avokatisë. Në vitin 2019 kreu studimet në Shkollën e Magistraturës së Republikës së Shqipërisë / Profili Gjyqtar.

Z. Artur Prenga ka ushtruar funksionin e tij si:

- Gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, me vendimin Nr.50, datë 29.01.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
- Gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me vendimin Nr. 365, datë 14.09.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe me vendimin Nr. 390, date 19.09.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
- Gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, 1 Maj 2023.
- Gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, 16 Tetor 2023.

Z. Artur Prenga ka dhënë kontributin e tij si Ekspert dhe Ekspert-Lehtësues në një sërë aktiviteteve trajnuese të organizuara nga Shkolla e Magistraturës e Republikës së Shqipërisë.



Si edhe shprehet filozofi francez Jacques Maritain, “**Mirënjohja është forma më e rafinuar e mirësjelljes.**”, Koordinatorin për të Drejtën e Informimit, sektori i Marrëdhënieve me Publikun dhe Median, shpreh mirënjohjen për të gjithë Trupën Gjyqësore dhe Sekretarët Gjyqësorë të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan të cilët po përballojnë punën e një numri të lartë çështjesh për gjykim, për të cilat punohet me shumë përkushtim çdo ditë në uljen e numrit të BackLog-ut, Gjyqtarin e Medias z. Ardit Kuka për suportin e pakushtëzuar dhe kontributin profesional në sigurimin e një komunikimi profesional, transparent dhe efikas me përfaqësuesit e medias dhe mbështetjen e vazhdueshme profesionale për realizimin e objektivave të Planit Strategjik të Komunikimit, Ish-Zv/Kryetaren e Gjykatës znj. Matilda Fetau e cila besojë dhe inicjojë suportimin profesional për realizimin e objektivave të Planit Strategjik të Komunikimit, si edhe krijimin fillestar të mundësive të aksesit të të rinjve dhe grupeve të interesit në Gjykatë, Zv/Kryetarin e Gjykatës z. Artur Prenga për mbështetjen e vazhdueshme në realizimin e Planit Strategjik të Komunikimit, për suportimin profesional dhe angazhimin maksimal në rritjen e transparencës së Gjykatës dhe besimit të publikut, për krijimin dhe rritjen e mundësive të lehtësimit të aksesit të publikut, medias dhe grupeve të interesit në Gjykatë, për krijimin e Marrëveshjeve me Institucione të Larta Arsimore në mbështetje të zhvillimit të praktikave, intershipit si edhe projekteve që kanë në fokus mbështetjen profesionale dhe lehtësimin e aksesit të të rinjve, kryesisht studentëve, në gjykatë.

Mirënjohje për të gjithë institucionet që kanë ndërvepruar me Gjykatën, përfaqësuesit e mediave në qytetin e Elbasanit për komunikimin profesional mes tyre dhe Gjykatës, bashkëpunimet e realizuara në kuadër të mirëinformimit të publikut.

Falenderime për avokatët që janë zëri kryesor i mbrojtjes së të drejtave të palëve në proces gjyqësor për ndërveprimin e krijuar mes tyre dhe Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun në lehtësimin e mirëinformimit të palëve në proces gjyqësor.

Falenderime për Drejtuesit e Institucioneve Arsimore, mësuesit asistues, studentët, nxënësit të cilët kanë treguar përkushtim dhe devotshmëri të lartë në çdo projekt të ndërmarrë, dhe grupe të tjerë interesi për bashkëpunimin efektiv që synon mirëinformimin, afrimin dhe lehtësimin e aksesit në Gjykatë. Palët në proces dhe publikun për mirëkuptimin e tyre në këtë proces të vështirë dhe sfidues!

Mbetemi të angazhuar për të rritur dhe përmirësuar transparencën, komunikimin dhe mirëinformimin publik me mediat, publikun dhe grupet e interesit, për lartësimin e konceptit të një Gjykate të Hapur, sa më afër publikut dhe grupeve të interesit.

Për lexuesin:

Jean- Paul Sartre tek “Fjalët” shprehet: “**Nëpër libra e kam takuar gjithësinë: të përvetësuar, të klasifikuar, të etiketuar, të menduar...**”, urojmë që në albumin e kësaj Reviste Nr. 2, t’iu kemi sjellë më afër Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe veprimtarinë e saj.

Falenderime të përzemërta!
Manjola Kume

Maj 2025,